



HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)



NJERIU I VOGËL NË
KULLË

Në ç'botë jetoni?

Një botë me bazë të fortë me njerëz dhe drunjë, oqeane me re përmbi tyre dhe, edhe më lartë, zbraztinë e pafund të hapësirës?

A jeni ju njëri nga miliarda njerëz në atë botë?

Nëse u përgjigjeni këtyre pyetjeve me "po," atëherë gaboheni!

Nëse keni qenë në gjendje t'iu përgjigjeni atyre me "po," atëherë kjo nënkupton se gjatë gjithë jetës suaj ju ndoshta e keni shpërfillur një të vërtetë më se të rëndësishme.

E vërteta është se ju fare nuk jetoni në një botë të tillë siç është përshkruar më lartë. Në botën tuaj, nuk ekziston as edhe distanca prej pak metrash, e lëre më prej miliarda kilometrash apo galaktika të largëta me vite drite. Në të vërtetë ju jetoni në një hapësirë të vogël të mbyllur – në një dhomë të vogël të mbyllur në majë të një kulle gjigante. Ju kurrë nuk e keni lëshuar atë dhomë. Ju kurrë nuk keni dalë jashtë saj apo nuk keni qenë kudo tjetër. Gjithë çfarë keni parë ju janë trajta të ndryshme, njerëz dhe hapësira që reflektohen në muret e asaj dhome. Ju keni dëgjuar vetëm tingujt e emituar nga altoparlantët e fshehur aty brenda. Në fakt, në atë dhomë të vogël në majë të kullës, nuk ekziston askush tjetër pos jush. Ju jeni tërësisht vetëm!

"Kulla" për të cilën ne po flasim është trupi juaj dhe dhoma e vogël në majë të tij (me fjalë të tjera, bota juaj) është truri juaj.

Ne do ta shpalojmë këtë të vërtetë në këtë libër. Ajo që ne do të shpjegojmë këtu, sipas të gjitha gjasave, do të jetë në kundërshtim me shumë ide dhe koncepte me të cilat ju jeni familiarizuar deri më tani. Megjithatë është një e vërtetë konkrete e bazuar në dëshmi shkencore. Prandaj, është e pamundur që të hidhet poshtë kjo e vërtetë kur njeriu mendon për të në një mënyrë të arsyeshme dhe logjike, në vend se t'iu përmbahet paragjytimeve të njohura.

ABOUT THE AUTHOR



Adnan Oktar, i cili shkruan me pseudonimin Harun Jahja, u lind në Ankara më 1956. Që nga vitet e 1980-ta ka botuar shumë libra lidhur me çështjet e besimit dhe shkencës. Harun Jahja është i njohur si autor i veprave të rëndësishme që demaskojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavlerë dhe lidhjet e errëta ndërmjet Darwinizmit dhe ideologjive të përgjakshme siç janë fashizmi dhe komunizmi.

Të gjithë librat e autorit janë të përqendruara në një qëllim të vetëm: të bartet porosia e Kur'anit të njerëzimit, të inkurajojnë lexuesit e tyre në të menduarit e çështjeve themelore lidhur me fenë siç është ekzistenca dhe njëësia e Allahut dhe Jeta e përtejme, dhe ta vënë në dukje themelin e brishtë dhe të prishur të ideologjive të sistemeve të pafe.

Më tepër se 300 punime të tij, të përkthyer në 63 gjuhë të ndryshme, kanë një rreth të gjerë lexuesish në mbarë botën.

Me vullnetin e Zotit, këto libra do të jenë mjete përmes të cilave njerëzimit në shekullin 21 do të arrin paqen, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُهُ
مُحَمَّدٌ

PËR LEXUESIN

• Arsyja pse një kapitull i veçantë i është kushtuar teorisë së evolucionit është se kjo teori përmban bazat e të gjitha filozofive anti-shpirtërore (fetare). Pasi që Darwinizmi kundërshton faktin e krijimit, dhe me këtë, ekzistencën e Allahut, në këto 140 vitet e fundit ka bërë që shumë njerëz ta braktisin besimin e tyre apo të bien në dyshim. Kështu që, t'i tregohet çdonjërit se kjo teori është një mashtrim është një shërbim i domosdoshëm, është një detyrë shumë e rëndësishme. Disa nga lexuesit tanë mund të kenë shansin që të lexojnë vetëm një nga librat tonë. Kështu që, ne mendojmë se është me vend që një kapitull t'ia kushtojmë kësaj teme.

• Të gjitha librat e autorit shpjegojnë në dritën e vargjeve Kur'anore çështje që kanë të bëjnë me besimin dhe njerëzit ftohen që të mësojnë fjalët e All-llahut dhe të jetojnë sipas tyre. Të gjitha temat që kanë të bëjnë me vargjet e All-llahut janë të sqaruara në atë mënyrë sa që nuk lënë hapësirë për dyshim apo pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i qartë dhe i rrjedhshëm bëjnë që lexuesi i çdo moshe dhe nga cilido grup shoqëror t'i kuptoj ato me lehtësi. Ky tregim efektiv dhe i qartë bën të mundur që ato të lexohen shumë shpejt. Edhe ata të cilët ashpërsisht kundërshtojnë natyrën shpirtërore janë të influencuar nga faktet që këto libra dokumentojnë dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

• Ky dhe të gjithë librat e tjerë të autorit mund të lexohen në mënyrë individuale, apo të diskutohen në grup. Lexuesit e etshëm që të marrin sa më shumë nga librat e shikojnë të dobishëm diskutimin duke ia treguar njëri tjetrit mendimet dhe përvojat.

• Përveq kësaj, është në shërbim të madh të religjionit që të kontribohet në prezantimin dhe leximin e këtyre librave, të cilat janë të shkruara vetëm për kënaqësin e All-llahut. Të gjithë librat e autorit janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, ata të cilët dëshirojnë t'ju komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, njëra nga metodat më efektive është inkurajimi i tyre që të lexojnë këta libra.

• Shpresojmë se lexuesi do të shikojë pasqyrën e librave të tjerë në fund të këtij libri dhe të vlerësoj materialin e pasur në çështjet e lidhura me besimin, të cilat janë të dobishme dhe kënaqësi për t'u lexuar.

• Në këta libra, nuk do të gjeni, sikurse në disa libra tjerë, pikëpamje personale të autorit, sqarime të bazuara në burime të dyshimta, stile të zhveshura nga respekti dhe nderimi i duhur i temave të shenjta, e as rrëfrime të pashpresa, dyshim-nxitëse dhe pesimiste që krijojnë dyshime në mendje dhe devijime në zemër.

The image features a highly decorative golden border with intricate floral and scrollwork patterns. Inside this border, there are four ornate golden corner pieces and two horizontal decorative flourishes at the top and bottom. A large, double-lined golden oval frame is centered on the page. The text is rendered in a classic, serif font with a slight shadow effect.

**NJERIU I VOGËL
NË KULLË**

A decorative golden flourish consisting of symmetrical floral and scrollwork elements, framing the author's name.

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR



NJERIU I VOGËL NË KULLË

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR



PËR AUTORIN


Autori, i cili shkruan me pseudonimin Harun Jahja, u lind në Ankara më 1956. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Ankara, pastaj studioj artet në Universitetin Mimar Sinan të Stambollit dhe filozofinë në Universitetin e Stambollit. Që nga 1980 ka botuar shumë libra lidhur me çështjet e besimit dhe shkencës. Harun Jahja është i njohur si një autor që ka shkruar shumë punime në demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, shfuqizimin e pohimeve të tyre dhe lidhjen e errët ndërmjet Darwinizmit dhe ideologjive të përgjakshme siç janë fashizmi dhe komunizmi.

Punimet e Harun Jahjasë, të përkthyer në 63 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion me një total prej më shumë se 55,000 faqesh me 40,000 ilustrime.

Pseudonimi i tij përbëhet nga emrat "Harun" (Aron) dhe "Jahja" (Gjon), në përkujtim të profetëve të nderuar të cilët luftuan kundër mungesës së besimit (fesë). Vula e Profetit në kopertinën e librave ka kuptim simbolik që është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ajo prezanton Kur'anin (shpalljen e fundit) dhe Profetin Muhamed, i fundit nga profetët. Nën udhëzimin e Kur'anit dhe sunetit autori qëllim të tij bën përgënjeshttrimin e doktrinave fundamentale të ideologjive pa fe dhe ka "fjalën e fundit" për të shuar plotësisht kundërshtimet e ngritura kundër religjionit. Vula e Profetit të fundit, i cili arriti mençuri dhe moral perfekt, përdoret si një shenjë e qëllimit të tij të thënies së fjalës së fundit.

Të gjithë librat e autorit janë të përqendruara në një qëllim: të bartet porosia e Kur'anit te njerëzit, inkurajimi i tyre në të menduarit e çështjeve themelore lidhur me fenë (siç është ekzistenca e Zotit, uniteti i Tij dhe Amshueshmëria), dhe të ekspozohet themeli i brishtë dhe i prishur i ideologjive të sistemeve pa fe.

Punimet e Harun Jahjasë lexohen në shumë vende, nga India në Amerikë, Angli në Indonezi, Polonia në Bosnje, Spanja në Brazil, Malezja në Itali, Franca në Bullgari dhe Rusi. Disa nga librat e tij janë në dispozicion në gjuhën angleze, frënge, gjermane, spanjolle, italiane,



portugeze, urdeze, arabe, shqipe, kineze, suahili, hausa, dhivehi (që flitet në Maldive), ruse, serbo-kroate (boshnjake), polake, malai, ujgure, turke, indoneziane, bengaleze, daneze dhe suedeze.

Shumë të çmuara në mbarë botën, këto punime janë bërë instrumente që shumë njerëz të ri-gjejnë besimin në Zot dhe shumë të tjerë të depërtojnë më thellë në fenë e tyre. Stili i qartë, i lehtë dhe i rrjedhshëm për tu kuptuar iu jep këtyre librave një veçanti, të cilat drejtpërdrejt kanë efekt në secilin që i lexon dhe i studion ato. Imune ndaj kundërshtimeve, këto punime karakterizohen me veçori të efektit të menjëhershëm, rezultate definitive dhe të pakundërshtueshme. Ata të cilët lexojnë këto libra dhe i kushtojnë vëmendje serioze nuk mundën më tutje sinjerisht të përkrahin filozofin materialiste, ateizmin apo çfarëdo ideologjie apo filozofie të prishur. Nëse vazhdojnë edhe më tutje ashtu, do të jetë vetëm për shkak të këmbënguljes sentimentale meqenëse këto libra përgënjeshtrojnë ideologjitë e tilla që nga themeli. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore të mohimit janë tashmë ideologjikisht të mposhtura duke iu falënderuar përmbledhjeve të librave të shkruara nga Harun Jahja.


Nuk ka dyshim se këto veçori rezultojnë nga urtësia dhe qartësia e Kur'anit. Modestia e autorit synon të shërbej si mjet në kërkimin e njerëzimit për në shtegun e drejtë të Zotit. Asnjë përfitim material nuk kërkohet në botimin e këtyre punimeve.

Duke i marr parasysh këto fakte, ata të cilët inkurajojnë njerëzit që të lexojnë këta libra, të cilët hapin "sytë" e zemrës dhe udhëzojnë për t'u bërë shërbëtorë më të devotshëm të Zotit, ofrojnë një shërbim tejet të çmueshëm.

Ndërkaq, përvoja ka treguar se është humbje kohe dhe energjie propagandimi i librave të tjerë, të cilët sjellin vetëm konfuzion dhe dyshim në zemrat e njerëzve. Është e qartë që për librat që kanë efekt aq të madh, është e pamundur që të theksohet më tepër fuqia letrare e autorit se sa qëllimi fisnik i shpëtimit të njerëzve nga humbja e besimit. Ata të cilët dyshojnë në këtë mundën me lehtësi të shikojnë se qëllimi i vetëm i Harun Jahjasë është që të mposht mosbesimin dhe të përhap vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi manifestohen në bindjen e lexuesit.

Një çështje duhet të mbahet në mend: Arsyeja kryesore e mizorisë së vazhdueshme, konfliktit, dhe sprovave që shumica e njerëzve kalojnë është mbizotërimi i ideologjisë së mosbesimit. Kjo gjendje mund të marr fund vetëm me mposhtjen ideologjike të mosbesimit dhe me transmetimin e mrekullive të krijimit dhe moralit të Kur'anit në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke pasur parasysh gjendjen e botës sot, e cila udhëheq njerëzit në tatëpjetën e spirales së dhunës, korrupsionit dhe konfliktit, është e qartë se ky shërbim duhet të ofrohet sa më shpejt dhe në mënyrë efektive. Përndryshe, mund të jetë shumë vonë.


Nuk është ekzagjerim të thuhet që përmbledhja e librave të Harun Jahjasë kanë këtë rol prijës. Me vullnetin e Zotit, këto libra do të jenë mjete përmes të cilave njerëzit në shekullin 21 do të arrin paqen, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.



All translations from the Qur'an are from
The Noble Qur'an: a New Rendering of its Meaning in English
by Hajj Abdalhaqq and Aisha Bewley, published by Bookwork,
Norwich, UK. 1420 CE/1999 AH.

Website: <http://www.harunyahya.com>
E-mail: info@harunyahya.com

NJERIU I VOGËL NË KULLË





PËRMBAJTJA

PARALAJMËRIM.....14

PARATHËNIE.....18

BOTA E VOCKËL BRENDË

KAFKËS.....22

Jashtë nuk ka dritë24

Nuk është syri ai që sheh.....27

Muri prej tri-etapash midis jush dhe botës së jashtme.....30

Trupi ynë dhe ëndrrat tona.....33

**NJERIU I VOGËL NË MAJË TË
KULLËS.....38**

**Kulla dhe dhoma e mbyllur në majë të
saj.....43**

**BESIMI I GABUAR NË
KULLË.....52**

**Materia e krijuar në sferën e perceptimeve dhe të
imagjinatës.....54**

**Materializmi: Një pikëpamje hipotetike e jetës së
kësaj bote që konsiderohet si reale.....58**

**Përrjashtimi i konceptit të
vendndodhjes.....60**


**Raportet e shkakut dhe pasojës të përcaktuara nga
Allahu.....65**

Përfundim67

**SHTOJCË: KOMENTET LIDHUR ME NJERIUN NË
KULLË.....64**

**SHTOJCË II: MASHTRIMI I
EVOLUCIONIT.....70**





The Little
Man in the
Tower

PARALAJMËRIM

Sekreti përtej materies nuk është Uahdetul Vuxhud

7

ema e quajtur “Esenca e vërtetë e materies” është kritikuar prej disa njerëzve. Duke e keqkuptuar thelbin e kësaj teme, këta njerëz pohojnë se ajo që është shpjeguar si fshehtësia përtej materies është identike me mësimin e Uahdetul Vuxhud. Le të themi, para së gjithash, se autori i këtij libri është një besimtar që vepron saktësisht në përputhje me doktrinën e Ehlus Sunnetit dhe nuk e mbron pikëpamjen e Uahdetul Vuxhud.

Megjithatë, duhet të përkujtojmë gjithashtu se Uahdetul Vuxhud është mbrojtur nga disa dijetarë kryesor Islamik duke përfshirë Muhjiddin Ibn el-‘Arabi. Është e vërtetë se dijetarë të shumtë të rëndësishëm Islamik të cilët e kanë përshkruar konceptin e Uahdetul Vuxhud në të kaluarën e kanë bërë këtë duke i marr parasysh disa çështje që ndodhen në këta libra. Megjithatë, ajo që shpjegohet në këta libra nuk është e njëjtë me Uahdetul Vuxhud.

Disa prej atyre të cilët mbrojtën pikëpamjen e Uahdetul Vuxhud u mbërthyen nga disa mendime të gabuara dhe bën disa pohime që

bien në kundërshtim me Kur'anin dhe doktrinën e Ehlus Sunnetit. Ata, për shembull, e refuzuan plotësisht krijimin e Allahut. Megjithatë, kur flitet për çështjen e fshehtësisë përtej materies, pa dyshim se nuk ekziston ndonjë pohim i tillë. Kjo pjesë sqaron se të gjitha qeniet janë krijuar nga Allahu dhe se origjinalet e këtyre qenieve shihen prej Tij ndërsa njerëzit shohin vetëm pamjet e këtyre qenieve të formuara në trurin e tyre.

Malet, fushat, lulet, njerëzit, detërat – shkurt çdo gjë që shohim dhe çdo gjë për çka Allahu në Kur'an na bën me dije që ekziston dhe që Ai krijoi nga asgjëja është krijuar dhe me të vërtetë ekziston. Mirëpo, njerëzit nuk mund të shohin, ndiejnë apo dëgjojnë natyrën e vërtetë të këtyre qenieve përmes organeve të tyre shqisore. Ajo që ata shohin dhe ndiejnë janë vetëm kopje që paraqiten në trurin tonë. Kjo është një e vërtetë shkencore e mësuar në të gjitha shkollat e kryesisht në medicinë. E njëjta vlen për artikullin që jeni duke e lexuar tani; nuk mund ta shihni e as ta prekni natyrën e tij të vërtetë. Drita që vjen nga origjinali shndërrohet nga disa qeliza në sytë tonë në sinjale elektrike, të cilat pastaj barten në qendrën e shikimit në pjesën e pasme të trurit tonë. Aty është vendi ku krijohet pamja e këtij artikulli. Me fjalë të tjera, ju nuk po e lexoni një artikull i cili ndodhet para syve tuaj përmes syve tuaj; në të vërtetë, ky artikull është krijuar në qendrën e shikimit në pjesën e pasme të trurit tuaj. Artikulli që po e lexoni tani është një “kopje e këtij artikulli” brenda trurit tuaj. Artikulli origjinal shihet nga Allahu.

Si përfundim, fakti që materia është një iluzion i formuar në trurin tonë nuk e “hedh poshtë” materien, por na ofron ne informacion lidhur me natyrën reale të materies: se asnjë person nuk mund të ketë lidhje me origjinalin e saj.

Ky fakt pasqyrohet në librin tonë Idealizmi Filozofia e Matriksit dhe Natyra e Vërtetë e Materies si vijon:

Materia ekziston jashtë nesh, por ne nuk mund ta arrijmë atë

... [T]ë thuhet se materia është një iluzion nuk do të thotë se ajo nuk ekziston. Pikërisht e kundërta: pa marr parasysh se a e perceptojmë ne botën fizike apo jo, ajo ekziston. Por ne e shohim atë si një kopje në trurin tonë, me fjalë të tjera, si një interpretim të shqisave tona. Prandaj, për ne bota fizike e materies është një iluzion.

Materia jashtë nesh nuk shihet vetëm nga ana jonë, por edhe nga qeniet e tjera. Engjëjt që Allahu i ka ngarkuar të jenë vëzhgues e shohin po ashtu këtë botë:

Dy engjëj i rrinë atij nga e djathta dhe e majta, dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë). (Surah Kaf: 17-18)

Më e rëndësishmja është që Allahu sheh gjithçka. Ai e krijoi këtë botë deri në imtësinë më të vogël dhe e sheh atë në të gjitha gjendjet e saj. Siç na bën me dije Ai në Kur'an:

... Ta keni frikë Allahun dhe dijeni se Allahu i sheh mirë të gjitha punët që bëni ju. (Sure Bekare: 233)

Thuaj: “Allahu mjafton për dëshmitar midis meje dhe jush. Vërtet, Ai i njeh dhe i sheh mirë robërit e Vet”. (Sure Isra’: 96)

Nuk duhet harruar që Allahu mban shënimet për çdo gjë në librin e quajtur Leuhi Mahfudh (Librin e Ruajtur). Edhe nëse ne nuk i shohim të gjitha gjërat, ato janë në Leuhi Mahfudh. Allahu shpall se Ai mban shënim çdo gjë në “Mëmën e Librit” të quajtur Leuhi Mahfudh me vargjet në vazhdim:

E ai është te Ne, në Librin kryesor (Leuhi-mahfûdh), i lartësuar dhe plot urtësi. (Sure Zuhruf: 4)

... tek Ne është Libri që i ruan të gjitha. (Sure Kaf: 4)

S'ka asgjë të fshehtë në qiell dhe në Tokë, që të mos jetë
e shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh). (Sure
Neml: 75)



PARATHËNIE

N

ë ç'botë jetoni?

Një botë me bazë të fortë me njerëz dhe drunjë, oqeanë me re përmbi tyre dhe, edhe më lartë, zbraztinë e pafund të hapësirës?

A jeni ju njëri nga miliarda njerëz në atë botë?

Nëse u përgjigjeni këtyre pyetjeve me "po," atëherë gaboheni!

Nëse keni qenë në gjendje t'iu përgjigjeni atyre me "po," atëherë kjo nënkupton se gjatë gjithë jetës suaj ju ndoshta e keni shpërfillur një të vërtetë më të rëndësishmen.

E vërteta është se ju fare nuk jetoni në një botë të tillë siç është përshkruar më lartë. Në botën tuaj, nuk ekziston as edhe distanca prej pak metrash, e lëre më prej miliarda kilometrash apo galaktika të largëta me vite drite. Në të vërtetë ju jetoni në një hapësirë të vogël të mbyllur – në një dhomë të vogël të mbyllur në majë të një kulle gjigante. Ju kurrë nuk e keni lëshuar atë dhomë. Ju kurrë nuk keni dalë jashtë saj apo nuk keni qenë kudo tjetër. Gjithë çfarë keni parë ju

janë trajta të ndryshme, njerëz dhe hapësira që reflektohen në muret e asaj dhome. Ju keni dëgjuar vetëm tingujt e emituar nga altoparlantët e fshehur aty brenda. Në fakt, në atë dhomë të vogël në majë të kullës, nuk ekziston askush tjetër pos jush. Ju jeni tërësisht i vetëm!



“Kulla” për të cilën po flasim ne është trupi juaj dhe dhoma e vogël në majë të tij (me fjalë të tjera, bota juaj) është truri juaj.

Truri juaj është një dhomë e mbyllur jashtë së cilës nuk mund të dilni kurrë, pasi që çdo gjë që mendoni se është origjinali i materies në realitet përbëhet prej perceptimeve që ju i përjetoni në qendrat e të pamurit apo të dëgjuarit në trurin tuaj. Ju kurrë nuk mund t’i anashkaloni ato perceptime dhe ta përjetoni “materien e vërtetë” drejtpërdrejt, me fjalë të tjera, materien origjinale që ekziston jashtë trurit tuaj. Ju mund t’i shihni sinjalet elektrike që arrijnë në qendrën e shikimit të trurit, por kurrë nuk mund ta shihni burimin e vërtetë të atyre sinjaleve. Thënë troç, ju e shihni ekranin e kinemasë në muret e “dhomës” suaj, por kurrë nuk mund t’i përjetoni drejtpërdrejt origjinalet e atyre pamjeve.

Ne do ta shpalojmë këtë të vërtetë në këtë libër. Ajo që ne do të shpjegojmë këtu, sipas të gjitha gjasave, do të jetë në kundërshtim me shumë ide dhe koncepte me të cilat ju jeni familiarizuar deri më tani. Megjithatë është një e vërtetë konkrete e bazuar në dëshmi shkencore. Prandaj, është e pamundur që të hidhet poshtë kjo e vërtetë kur njeriu mendon për të në një mënyrë të arsyeshme dhe logjike, në vend se t’iu përmbahet paragjykimeve të njohura.

Mos harroni kurrë se injorimi i të vërtetës apo mospranimi për të menduar për të nuk i sjell asnjë dobi një personi. Nëse dikush thotë: “Jo, unë jetoj në një planet në një gjithësi të pafund, jo në një dhomë të mbyllur,” atëherë ai duhet ta dëshmojë këtë të vërtetë. Nëse nuk mundet, atëherë besimi i verbër në një ide të tillë vetëm se do të bëjë që ai të vazhdojë të mashtrohet.





-I-
The Tiny
World
Inside
the Skull



-I-


BOTA E VOCKËL
BRENDA KAFKËS

Njerëzit mund të mashtrohen nga pamjet shumë bindëse, deri në atë pikë sa të mund të pandehin se këto pamje janë “të vërteta.”

Shfaqja e filmit të parë në histori është një ilustrim interesant lidhur me këtë. Në Paris më 1885, dy shpikës francez, Auguste dhe Louis Lumière, shfaqën në një ekran imazhin e një treni që i afrohej një stacioni. Edhe pse treni ishte vetëm dy-dimenzional dhe u shfaq në bardh e zi që dridhej, prapsepap shumica e shikuesve në sallë ikën në panik, sepse besuan se treni do t'i shtypte ata!

Siç na dëshmon ky shembull, perceptimi i çfarëdo imazhi nga njeriu si “i vërtetë” është ngusht i lidhur me cilësinë teknike të atij imazhi. Sot, megjithatë, edhe efekte më realiste kinematike mund të arrihen duke iu

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR



Në filmin e parë të shfaqur në vitin 1895, shikuesit u larguan në panik duke menduar se treni që shfaqej në pëlhurë e kinemasë ishte i vërtetë.

falënderuar syzeve speciale që formojnë holograme (imazhe të perceptuara si tre-dimensionale). Njerëzit që vënë këso syze pandezin se bota virtuale që shfaqet para syve të tyre është reale dhe reagojnë në përputhje me rrethanat. Mirëpo gjatë gjithë kohës, ata prapë janë të vetëdijshëm se ky imazh është një imazh krejtësisht virtual.

Mirëpo si qëndron puna me gjendjen e imazheve që ne i quajmë “bota



Syze speciale prodhojnë imazhe tre-dimensionale që mund të ndikojnë që pranuesi të mendojë se ato janë reale.

reale”? A ka mundësi që edhe këto të jenë të ngjashme me hologramet që na mashtrojnë me cilësinë e tyre teknike?

Për të gjetur përgjigjen në këto pyetje, së pari dhe para së gjithash na duhet të rishqyrtojmë atë që ne e njohim si “shikim” dhe procesin e të pamurit në përgjithësi.

Jashtë nuk ka dritë

Në dritën e zbulimeve të fundit, shkencëtarët kanë arritur në një përfundim më se interesant: Në fakt, bota jonë është sterrë e zezë. Tani dihet se drita është një koncept krejtësisht subjektiv; me fjalë të tjera, ajo është thjeshtë një perceptim i formuar në mendjet e njerëzve. Në të vërtetë, nuk ekziston dritë në botën e jashtme. As llambat, as dritat e përparme të makinave, madje as Dielli, të cilin ne e konsiderojmë si burimin më të madh dhe më të fuqishëm të dritës, nuk emitojnë dritë fare.

Gjithë çka emitojnë Dielli dhe “burimet e tjera të dritës” janë fotonet, lloje të ndryshme të grimcave elektromagnetike të gjatësive të ndryshme valore. Këto grimca shpërndahen në tërë gjithësinë në mënyrën të cilën e lejojnë strukturat e tyre. Disa prej tyre e arrijnë Tokën tonë, ku përsëri prodhojnë llojet e efekteve të përcaktuara nga strukturat e tyre dhe të cilat ndryshojnë, varësisht nga vëllimi, pesha, shpejtësia dhe frekuenca e grimcës.

Për shembull, shumë grimca radioaktive hyjnë në trupat tonë dhe i përshkojnë ata. Ato mund të ndalen vetëm me anë të mburojave të plumbit. Disa nga këto grimca janë aq të rënda dhe të ngarkuara me energji sa që rëndom shkatërrojnë çfarëdo molekule me të cilën takohen dhe vazhdojnë rrugën e tyre, me një devijim të vogël. Ky fenomen përbën bazën në të cilën rrezatimi nxit kancerin. Makinat me rreze X përdorin rrezet X – një formë më e dobët e rrezatimit – dhe e shndërrojnë efektin e radio valëve elektromagnetike në “dritë të dukshme,” domethënë, në një formë të dukshme për syrin tonë.

Pasi që radio valët nuk përmbajnë asnjë grimcë, ato nuk u shkaktojnë


HARIJN JAHJA - ADNAN OKTAR



Në mesin e atyre rrezeve të padukshme për syrin tonë janë rrezet X që përdoren në diagnozat mjekësore.

dëm njerëzve në momentin e përplasjes. Këto valë nuk mund të perceptohen nga asnjë shqisë e jona. Zhurma kërcëlluese që dëgjohet në mungesë të çfarëdo transmetimi në radiot e shtëpive tona është në të vërtetë tingulli i rrezatimit të sfondit kozmik – energji e mbetur nga “Big Bengu,” shpërthimi përmes të cilit u krijua gjithësia. Fjala “tingull” këtu i referohet perceptimit që formohet në trurin tonë pasi radiot tona t’i kenë shndërruar këto valë në vibrime në ajër që veshët tonë mund t’i dëgjojnë.

Fotonet, burimi i perceptimit që ne i




Radio valët nuk mund të perceptohen nga asnjë prej shqisave tona. Mirëpo radiot në shtëpitë tona i shndërrojnë ato në valë zanore në një volum që veshët tonë mund ta dëgjojnë me lehtësi.

NJERIU I VOGËL NË KULLË

referohemi si “dritë,” janë grimca shumë më të lehta që zakonisht kthehen mbrapsht nga molekula e parë me të cilën ndeshen. Duke vepruar kështu, ato pothuajse nuk i shkaktojnë kurrfarë dëmi vendit të cilin e godasin. Për shkak të frekuencave të tyre – shpejtësia në të cilën ato vibrojnë – rrezet ultravjollcë janë të ngarkuara me energji më të madhe dhe mund të depërtojnë më thellë në lëkurat tona, duke i dëmtuar ndonjëherë kodet gjenetike të qelizave. Kjo është arsyeja pse ekspozimi i tepërt ndaj rrezeve të Diellit mund të rezultojë me kancer të lëkurës.

Ato fotone të njohura si infra të kuqe për shkak të frekuencave të tyre lënë pas një sasi të energjisë së tyre, duke e rritur shpejtësinë e vibrimit të atomeve aty – me fjalë të tjera, nxehtësinë në sipërfaqen të cilën e godasin. Për këtë arsye, rrezet infra të kuqe quhen gjithashtu rreze të nxehtësisë. Një stufë qymyri apo një nxemëse elektrike lirojnë sasi të mëdha të rrezatimit infra të kuq, i cili “shihet” apo thënë më mirë perceptohet nga trupat tonë si nxehtësi.

Frekuencat e disa fotoneve shtrihen mes atyre të rrezeve ultravjollcë dhe infra të kuqe. Kur këto bien në shtresën e retinës në anën e pasme të syve tonë, qelizat aty i shndërrojnë ato në sinjale elektrike. Ne atëherë i perceptojmë këto fotone, të cilat janë në të vërtetë grimca, si “dritë.” Po t’i



Syri ynë mund t’i perceptojë vetëm ato rreze drite që bien në spektrin midis ultravjollcës dhe infra të kuqes.

perceptonin qelizat në syrin tonë fotonet si “nxehtësi,” atëherë ajo që ne i referohemi si dritë, ngjyrë dhe errësi nuk do të ekzistojnë. Kur do ta shikonim një objekt, do ta perceptonim atë vetëm si diçka “të nxehtë” apo “të ftohtë.”

Nuk është syri ai që sheh

Këtë informacion teknik lidhur me format e ndryshme të rrezatimit e ofrojmë thjesht për të sqaruar se ato nuk e shkaktojnë efektin e njohur si “dritë.” Këto grimca radioaktive godasin, kërcejnë dhe nxisin efekte fizike dhe kimike që ndonjëherë shkaktojnë dëm. E megjithatë, efekteve që ato shkaktojnë nuk mund t’iu referohemi kurrë si dritë.

E vetmja arsye pse ne i përshkruajmë disa prej këtyre grimcave si “rreze drite” është se ato perceptohen prej syve tonë. Fotonet që bien në shtresën e retinës së syrit shndërrohen në impulse elektrike nga qelizat receptorë aty. Nervat pamore/optike bartin këtë rrymë elektrike në qendrën pamore në pjesën e pasme të trurit. Kjo qendër e interpreton këtë rrymë dhe shkakton imazhe.

Kur e hulumtojmë këtë sistem, arrijmë në një përfundim më se interesant: Në fakt, sytë tonë nuk kanë fare aftësi për të “parë.” Syri është vetëm një organ ndërmjetësues që i shndërron fotonet në sinjale elektrike. Ai nuk ka aftësi për të kuptuar dhe interpretuar. Nuk është syri ai që e vështron botën e ndritshme gjithandej përreth nesh. Asnjë ndjesi e dritës apo ngjyrës nuk formohet në sy.


Për ta kuptuar më mirë këtë koncept, le të mendojmë për definicionin teknik të të pamurit pak më detajisht.



Një zjarr gazi i ndezur emiton rrezatim infra të kuq, si edhe dritë.

NJERIU I VOGËL NË KULLË

Ne u japim emrin e një ngjyre fotoneve në frekuenca të ndryshme të vibrimit. Varësisht nga intensiteti i lëkundjeve të atyre fotoneve, ne u referohemi efekteve të dukshme që ato prodhojnë si ngjyrë e kuqe, e kaltër apo e verdhë. Kur të gjitha frekuencat bashkohen, rezultati është e bardha. Bora na duket e bardhë, sepse ajo i reflekton të gjitha frekuencat në dritën e diellit, kombinimi i të cilave prodhon të bardhën. Gjethet janë të gjelbërta, sepse ato i reflektojnë vetëm ato fotone në një frekuencë që jep ndjesinë e ngjyrës së gjelbërt, ndërsa i absorbon gjithë të tjerat. Qelqi është i tejdukshëm, mu sikurse ajri, sepse fotonet i përshkojnë ato tejprtej dhe arrijnë tek ne pothuajse pa hasur në çfarëdo pengese – si retë apo njollat që shkaktojnë mizat. Një copë pëlhure e zezë nuk reflekton asnjë ngjyrë sepse i absorbon pothuajse të gjitha fotonet që e godasin atë. Me fjalë të tjera, asnjë foton nuk e arrin syrin tonë prej saj dhe ne e perceptojmë atë vetëm si një trajtë të errët apo të zezë. Një pasqyrë e imiton një imazh për arsye se



Në fakt, syri ynë nuk posedon tiparin e "të pamurit." Syri është vetëm një njësi ndërmjetëse retina e të cilit i shndërron fotonet që e arrijnë atë në sinjale elektrike.

sipërfaqja e saj e lëmuar reflektuese nuk absorbon gadi asnjë prej fotoneve që e godasin atë, por i kthen ato mbrapsht. Ato pasojnë një rrjedhë paralele me njëra tjetrën pothuajse duke mos iu nënshtruar asnjë deformimi.

Thënë shkurt, konceptet e “dritës,” “të bardhës,” “të gjelbërtës” apo “të tejdukshmes” iu referohen perceptimeve në tru dhe janë përshkrime krejtësisht relative. E vërteta është se në botën e jashtme nuk ekziston as dritë e as ngjyrë. Ekzistojnë vetëm format e rrezatimit të cilat ne i perceptojmë në atë formë. Interpretimi na takon vetëm neve. Edhe nëse fotonet që arrijnë shndërrohen në sinjale elektrike dhe qendra pamore në sy posedon të njëjtat karakteristika, një gabim apo ndryshim strukturor që mund të ndodhte në sy do të bënte që i njëjti objekt të perceptohej në shumë mënyra të ndryshme. Kjo është arsyeja pse njerëzit që nuk i shohin ngjyrat i perceptojnë dhe interpretojnë ngjyrat e caktuara ndryshe prej njerëzve normal.

Thënë shkurt, lëvizjet e fotoneve të cilat ne i interpretojmë si dritë apo ngjyrë nuk janë asgjë më shumë se sa dukuri fizike që ndodhin në errësirën sterrë të zeze të trurit. Trupat tonë – përfshirë sytë tonë dhe e gjithë bota materiale që e perceptojmë si vizion të ndritshëm tre-dimenzional që disa njerëz pohojnë se paraqet një realitet absolut – të gjitha ekzistojnë përbrenda po kësaj errësire.

Muri prej tri-etapash midis jush dhe botës së jashtme

Një vështrim i afërt i këtyre fakteve shkencore zbulon një të vërtetë më se të rëndësishme: Ne kurrë nuk mund të vendosim kontakt të vërtetë, të drejtpërdrejt me botën e jashtme.

Për shembull, kur ne ulemi dhe shikojmë televizion, ne kurrë nuk mundemi me të vërtetë ta shohim ekranin. Gjithë çka që arrin tek ne janë fotonet që dalin nga tubi elektronik i fotografisë. Këto nuk janë dritë, por vetëm grimca valore. Ngjashëm, ne “i shikojmë” objektet në dhomë përmes fotoneve që ato reflektojnë, mu sikurse topi i tenisit që kërcen prej një muri

NJERIU I VOGËL NË KULLË

dhe kthehet drejt nesh. Me fjalë të tjera, madje edhe në këtë fazë, ne tashmë jemi të ndarë nga vet imazhi i televizionit.

Kur fotonet e tij arrijnë syrin tonë dhe e godasin retinën e syrit, ato shndërrohen në energji elektrike nga enzimet që ndodhen aty. Kjo përbën edhe një fazë tjetër midis televizionit dhe neve.

Kur nervat e bartin këtë energji elektrike në qendrën e të pamurit në trurin tonë, ajo përsëri ndërron formë, duke e marr formën të cilës ne i referohemi si “imazhe.” Kjo është faza e tretë. Vetëm një hap i vetëm mjafton për të thyer lidhjen midis ekranit të televizionit dhe neve, e prapsepap ne kemi të bëjmë në fakt me tri prej tyre.


Për të bërë një analogji, kjo ëshë sikurse të lozësh lojën e Telefonit, që gjithashtu njihet si Pëshpëritjet Kineze, me tre njerëz të ndryshëm në tri dhoma që janë të lidhura njëra me tjetrën. A e ka thënë me të vërtetë personi fjalinë që është pëshpëritur në veshin tuaj apo ndoshta personi i dytë apo i tretë e ka ndryshuar atë në njëfarë mënyrë? Mos vallë personi i tretë e ka shpikur atë në veten e tij? Kurrë nuk mund të jeni të sigurt. Madje nuk mund të jeni aspak të sigurt se çfarë kanë thënë në të vërtetë lojtari i dytë apo i tretë.

Për ta bërë edhe më të qartë këtë çështje, mund ta përmendim edhe një tjetër shembull. Imagjinoni që gjatë vitit të kaluar keni qenë i mbyllur të mbyllur në një dhomë të nëndheshme. E vetmja lidhje e juaj me botën e jashtme është një ekran televiziv me qark të mbyllur. Kur ta ndizni televizionin, lexoni mesazhin vijues:

Pamjet që do t'i shihni në këtë ekran po transmetohen drejtpërdrejtë nga kamerat në kontinentin Afrikan. Pamjet nga këto kamera janë duke u transmetuar live në drejtim të satelitëve dhe prej aty, tek receptorët mbi këtë dhomë, prej ku ato dërgohen në këtë dhomë.

A është i vërtetë ai mesazh apo jo? Kurrë nuk mund të jeni të sigurt, sepse secila fazë e transmetimit mbase mund të jetë krijuar nga një burim artificial. Në të vërtetë, kamerat – për të cilat thuhet se janë duke

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR



Secili imazh arrin në trurin tonë në tri faza, ngjashëm me lojën e fëmijëve të Pëshpëritjeve Kineze apo të Telefonit. Personi i fundit kurrë nuk mund të jetë i sigurt nëse fjalët e pëshpëritura në veshin e tij janë të njëjta me ato që janë thënë nga i pari.

transmetuar live nga Afrika – mund të jenë duke e shfaqur një video kasetë të regjistruar vite më parë. Kjo pamje e regjistruar paraprakisht mund të jetë ajo që arrin tek ju nga sateliti. Për më tepër, mund të mos ketë as kamera dhe as satelitë fare dhe ju mund të jeni një qenie të cilës i shfaqet një video kasetë nga dhoma ngjitur me tuajën. Nuk mund të jeni të sigurt se çka keni perceptuar, pa udhëtuar personalisht në Afrikë. E pasi që nuk jeni në gjendje ta braktisni dhomën, është e pamundur për ju që të shkoni vetë dhe ta shihni pamjen “origjinale” Afrikane.

Mirëpo, përkundër këtyre dyshimeve, çkado që keni përjetuar nga bota e jashtme para se të hyni në këtë dhomë – plus dituria se në fund do ta lëshoni atë – mund të ndikojë që ju të formoni një pikëpamje që ajo që shihni në ekran është e vërtetë, një realitet që ekziston diku “atje jashtë.” Por çfarë nëse ju do të jetonit në atë dhomë që nga lindja? Çka nëse kurrë nuk mund të largoheni? Çka nëse, për tërë jetën tuaj, e shihni “botën e jashtme” vetëm në atë ekran? Po të jetë kështu, ju nuk do të kishit prova që “ju bashkëveproni drejtpërdrejt me origjinalet” e atyre që shihni në ekranin e TV-së suaj. Sepse gjithë çka që vërtetë ishte atje ishin pamje në ekranin tuaj.

Fakte si këto në sferën e të pamurit, vlejné po ashtu edhe për shqisat e të dëgjuarit, prekjes, shijimit dhe nuhatjes. Të gjitha këto përshtypje ne i perceptojmë në dhomat e mbyllura të trurit tonë (qendrat e të dëgjuarit,

NJERIU I VOGËL NË KULLË

prekjes, shijimit dhe të nuhaturit). Kurrë nuk mund të vendosim kontakt të drejtpërdrejt me origjinalet e tyre në botën e jashtme. Tingujt që i dëgjojmë në radio formohen në qendrën e të dëgjuarit në trurin tonë. Në të vërtetë, nuk ekziston asnjë tingull jashtë nesh, vetëm lëvizjet fizike në ajër të cilave ne i referohemi si “valë zanore.” Pasi që u nënshtrohen proceseve të ndryshme në veshin e brendshëm, këto lëvizje fizike arrijnë tek ne si sinjale elektrike. Sinjalet elektrike që ne i perceptojmë a i përgjigjen gjësendi jashtë nesh apo jo? Kurrë nuk mund ta dijmë këtë. Duke u kthyer përsëri tek shembulli i dhomës së mbyllur, zëri i luanëve që hungërijnë në gjunglat e Afrikës mund të jenë në të vërtetë zëra të krijuar artificialisht në një studio mu pranë dhomës sonë.



Kur e shikojmë ekranin e një televizori, ne nuk mund ta dijmë nëse imazhi që ne mendojmë se po e vështrojmë drejtpërdrejtë, nga një vendndodhje e largët, është në të vërtetë transmetim i një shiriti të regjistruar paraprakisht nga dhoma ngjitur me tuajën.

Trupi ynë dhe ëndrrat tona

Deri tani, për të arritur një kuptim më të plotë të këtij koncepti, ne gjithmonë i kemi referuar objekteve të tjera. Ne kurrë nuk mund të perceptojmë “origjinalin” e një transmetimi televiziv, dhe as të dëgjojmë “origjinalin” e një talk show (emision bashkëbisedues) në radio. Të gjitha pamjet, tingujt, erërat dhe shijet formohen në qendrat përkatëse në trurin tonë. Ne nuk jetojmë në botën e jashtme, por në një botë brenda vetes sonë.

Një faktor që e bën këtë koncept të vështirë për t’u kuptuar është se njerëzit mashtrohen kur bëhet fjalë për vetë çështjen e trupave të tyre. Duart dhe këmbët që ata shohin kur shikojnë poshtë dhe perceptimet e prekjes në lëkurën e tyre bën që ata ta perceptojnë botën në një mënyrë krejtësisht të gabuar. Për shkak të përshtypjeve shqisore që ata i pranojnë, ata supozojnë se në të vërtetë janë duke jetuar në “botën e jashtme.

Mirëpo, e vërteta është se, sikurse me objektet e tjera, ne mund të bashkëveprojmë vetëm me perceptimin e trupit tonë në tru. I gjithë informacioni lidhur me trupin tonë – me fjalë të tjera, imazhet vizuale të tij dhe të gjitha perceptimet e tjera që arrijnë në trurin tuaj, janë perceptime në qendrën përkatëse brenda kafkës suaj.

Këtë mund ta kuptojmë më mirë kur i marrim parasysh ëndrrat. Kur ëndërroni, e shihni veten tuaj në botë tërësisht imagjinare. Objektet dhe njerëzit që i shihni rreth jush nuk kanë realitet. Toka ku ecni, qielli mbi kokën tuaj, shtëpitë, drurët, makinat dhe çdo gjë tjetër janë krejtësisht joreale. Ato nuk kanë origjinale materiale. Ato ndodhen në trurin tuaj apo, thënë më mirë, brenda mendjes suaj dhe askund tjetër.

Duke menduar më tej/më larg, e njëjta gjë vlen për trupat tonë. Kur shikoni poshtë në një ëndërr, siç jeni duke vepruar tani, ju perceptoni një trup me duar dhe krah, që ecën, merr frymë dhe përjeton ndjenja të prekjes. Ky trup që shihni në ëndrën tuaj mund të jetë shumë i ndryshëm nga ai që në të vërtetë posedoni. Ju mund të ëndërroni veten me tri duar, përbindësh me katër këmbë. Mund të përjetoni ndjenja të prekjes të tri duarve. Në një ëndërr tjetër, mund ta përjetoni veten si një krijesë me krah që fluturon dhe

NJERIU I VOGËL NË KULLË

të ndjeni se si rrahin këta krah në mënyrën më bindëse. Të gjithë këta trupa që mund të përjetojnë kur ëndërrojmë janë vetëm iluzione virtuale në trurin tuaj. Por ju i perceptoni ato sikur ato të ndodhen jashtë trurit tuaj.


Ky shembull dëshmon se edhe pse ju perceptoni trupat tuaj në mënyrën më reale, kjo nuk nënkupton se ju posedoni në të vërtetë një trup të tillë në kuptimin fizik. Në mungesë të një trupi të tillë fizik, ne ende përjetojmë perceptime fizike dhe trupore që ekzistojnë në tërësi në mendjet tona.

Çfarë, atëherë, është dallimi midis ëndërrimit dhe jetës reale? Është e vërtetë se ëndrrat zgjasin më pak, janë më pak konsekuente dhe të regullta në aspektin logjik, se sa perceptimet të cilave iu referohemi si jetë reale. Mirëpo, thënë teknikisht, nuk ekziston asnjë dallim midis ëndërrimit dhe “jetës reale,” sepse ato të dyja rezultojnë përmes stimulimit të qendrave shqisore brenda trurit.

Në fletët e mëparshme, ekzaminuam se çfarë ndodhë në aso zona siç janë qendrat e të pamurit dhe të dëgjuarit në tru për të prodhuar atë që ne i referohemi si “jetë reale.” Një enciklopedi përshkruan se si në të vërtetë ëndërrimi përjetohet në mënyrë saktësisht të njëjtë:

Ëndërrimi, sikurse të gjitha proceset mendore, është një produkt i trurit dhe i aktivitetit të tij. Pa marr parasysh se a është i zgjuar apo duke fjetur një person, truri vazhdimisht liron valë elektrike. Shkencëtarët i matin këto valë me një instrument të quajtur elektroencefalograf. Në të shumtën e rasteve gjatë fjetjes, valët trurore janë të gjata dhe të ngadalshme. Por në kohë të caktuara, ato bëhen më të vogla dhe më të shpejta. Gjatë periudhave të valëve të shpejta të trurit, sytë lëvizin me shpejtësi sikur të ishte ai që flen duke shikuar një sekuencë ngjarjesh. Kjo fazë e gjumit, e quajtur gjumë REM (Lëvizje e Shpejtë e Syve), është koha kur ndodhin shumica e ëndrrave. Nëse zgjohet gjatë gjumit REM, ka mundësi që njeriut t’i kujtohen detajet e ëndrrës... Gjatë gjumit REM, rrugët që bartin impulset nervore nga truri për në

HARIJN JAHJA - ADNAN OKTAR



Nëse ëndërrojmë se po fluturojmë, kjo nuk nënkupton se ne mund të fluturojmë me të vërtetë. Megjithatë, ndërsa zgjat ëndrra, ne jemi të bindur se e kemi këtë aftësi.

muskuaj bllokohen. Prandaj, trupi nuk mund të lëvizë gjatë ëndrrave. Gjithashtu, korteksi cerebrale – pjesa e trurit që kyqet në funksione më të larta mentale – është shumë më aktive gjatë gjumit REM se sa gjatë gjumit pa ëndrra. Korteksi stimulohet nga neuronet (qelizat nervore) që i bartin impulset nga zona e trurit e quajtur kërcelli i trurit.1

Me fjalë të tjera, një ëndërr nuk është asgjë më shumë se tërësia e të gjitha perceptimeve që burojnë nga interpretimi i impulseve që arrijnë pjesët përkatëse të trurit.

Vini re që ajo që ne i referohemi si “jetë reale” ndodhë në mënyrë saktësisht të njëjtë. Impulset elektrike i arrijnë pjesët përkatëse të trurit tonë. Atje ato interpretohen, pas së cilës ne perceptojmë tërësinë e këtyre perceptimeve si “botën reale.”



Kur e ëndërrojmë veten si një krijesë me krah, ne besojmë plotësisht se është ashtu.

NJERIU I VOGËL NË KULLË

Kjo na shpie në një pyetje vendimtare: Cili është burimi i gjithë këtyre perceptimeve? Ne jemi të prirur të besojmë se gjithmonë bashkëveprojmë me origjinalet e botës së jashtme. E vërteta është se ekziston materia në botën e jashtme, por ne kurrë nuk mund ta përjetojmë origjinalin e kësaj materie.

Për ta kuptuar më mirë këtë koncept, le të vazhdojmë të mendojmë për të ëndërruarit. Pyeteni një person që ëndërron këtë: “Cili është burimi i të gjitha perceptimeve që është duke i përjetuar?” Sipas të gjitha gjasave, ai person gjysmë i zgjuar do të përgjigjet: “Objektet në botën e jashtme. Sytë dhe veshët e mi i perceptojnë ato.” E megjithatë në këtë shembull nuk ekziston një botë e jashtme dhe as ndonjë trup fizik për ta perceptuar. Gjithëçka që përjetojnë ata që ëndërrojnë përbëhet vetëm prej sinjaleve të perceptuara nga qendrat përkatëse në trurin e tyre.

Gjithëçka që shohim, dëgjojmë, prekim, shijojmë apo nuhaTim përbëhet prej sinjaleve të perceptuara nga qendrat përkatëse në tru. Atëherë si mund të jemi të sigurt se e përjetojmë botën e jashtme origjinale?

Kushdo që pohon se është i sigurt për këtë pohon në të njëjtën kohë se ai është “njeriu i vogël në majë të kullës.”

Pse është kështu? Në kapitullin pasues do të shohim arsyen pse.

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR







-II-

The Little
Man at the
Top of the
Tower

-II-
NJERIU I VOGËLNË
MAJË TË KULLËS

Le të përmbledhim me pak fjalë atë që diskutuam në kapitullin e mëparshëm. Ne kurrë nuk mund të kemi njohuri të drejtpërdrejt të origjinaleve të gjërave që shohim, dëgjojmë, prekim dhe iu referohemi si “materie.” Në të vërtetë ne bashkëveprojmë me perceptimet që i përjetojmë në trurin tonë. Ne kurrë nuk mund të dalim jashtë trurit tonë për të ardhur në kontakt me origjinalet e gjërave që shohim, dëgjojmë, prekim dhe kështu, kurrë nuk mund të verifikojmë se si janë origjinalet e tyre. Nuk ekziston asnjë dallim teknik midis të ëndërruarit dhe jetës reale, që ne i perceptojmë të dyja brenda trurit tonë. Bota e gjerë që ne e imagjinojmë të jetë aq shumë e madhe është në të vërtetë një tërësi e perceptimeve të transmetuara në trurin tonë. Galaktikat gjigante, për të cilat mendojmë se janë me miliarda milje larg nesh, janë në të vërtetë vetëm perceptime në

qendrën pamore të trurit tonë. Ato nuk janë fare “jashtë në hapësirë,” por pikërisht brenda nesh.

Shumë njerëz, nëse jo gadi të gjithë, janë të pavetëdijshëm për këtë të vërtetë shumë të rëndësishme. E megjithatë edhe nëse të tjerët janë të pavetëdijshëm për këtë, ky nuk është arsyezim që edhe ne të jemi të pavetëdijshëm – sepse ne po ashtu i shohim “të tjerët” në fjalë si imazhe në trurin tonë. Ne i përjetojmë këto imazhe dhe jemi përgjegjës për të kuptuar atë që shohim. Madje edhe nëse dëgjojmë që çdonjëri rreth nesh të na thotë: “Kjo botë është reale, jo një perceptim,” kjo prap nuk ndryshon asgjë. Në një ëndërr, ju mund të dëgjoni me mija njerëz të bërtasin me një zë: “Kjo botë është reale, jo një perceptim”. Prapseprap ajo ëndërr së shpejti do të përfundojë. Gjithë ata njerëz befas do të zhduken. Përveç se ishin perceptime, asnjëri prej tyre nuk kishte ekzistuar në radhë të parë ndonjëherë.

Jeta reale, gjithashtu, do të përfundojë një ditë – me vdekje. Gjithëçka që shohim (duke përfshirë edhe ata të cilët na kanë thënë “ky është origjinali i botës”) do të zhduken, për t’u zëvendësuar nga një realitet krejtësisht të ri – domethënë, me botën e Ahiretit. Allahu e shpall këtë të vërtetë në Kur’an, kur Ai e përshkruan gjendjen e vështirë të atyre që i bëjnë qeniet dhe qëllimet e paqarta në këtë botë gjithë qëllimin e jetës së tyre – ose përndryshe kërkojnë ndihmë nga këto gjëra, duke i shndërruar këto në këtë mënyrë në idhuj.


... E, kur t’u vijnë të dërguarit Tanë (engjëj), për t’ua marrë shpirtin, do t’u thonë: “Ku janë idhujt që i adhuronit në vend të Allahut?” Ata do të thonë: “Na braktisën.” Kështu ata dëshmojnë kundër vetes, që kanë qenë mohues. (Sure A’raf: 37)

Ata që i kundërshtojnë faktet e paraqitura këtu janë materialistët, ata të cilët besojnë në mënyrë të gabueshme se materia është realiteti absolut dhe se mendja njerëzore është vetëm një formë tjetër e materies. Duke folur në mënyrë të përgjithësuar, materialistët nuk janë të gatshëm për të menduar dhe për të diskutuar të vërtetën e qartë të shpjeguar këtu, që ne kurrë nuk

NJERIU I VOGËL NË KULLË

mund të vendosim kontakt të drejtpërdrejt me materien. Shpeshherë ata frustrohen shume me këtë ide. Më parë në shekullin e tetëmbëdhjetë, materialistët u zemëruan kur filozofi dhe kleriku britanik Xhorxh Berkli shpjegoi në mënyrë sistematike që ajo që ne njohim për materie është në të vërtetë një strukturë perceptimesh në mendjet tona. Mendimtari materialist Samuel Xhonson, i cili jetoi në të njëjtën kohë, shqelmoi një gur dhe bërtiti me zë të lartë se duke vepruar kështu, ai e kishte “përgënjeshtuar” Berklin. Mirëpo, reagimi primitiv i Xhonsonit dhe pohimet e ngjashme të bëra nga materialistët e tjerë, të mëvonshëm – tregojnë vetëm se sa larg janë ata nga të kuptuarit e të vërtetës për materien. As shqelmimi i gurëve dhe as goditja e mureve nuk përbëjnë asnjë provë për atë se ata bashkëveprojnë drejtpërdrejt me origjinalet e gurëve dhe mureve. Çdo gjë që ne bëjmë dhe ndiejmë në atë moment është një grup perceptimesh brenda trurit tonë. Dikush që shqelmon një gur apo grushton një mur është duke shqelmuar dhe grushtuar në fakt perceptimin e gurit apo të murit brenda trurit të tij. Me të vërtetë, ata mund ta shqelmojnë një gur në mënyrë po aq realiste në ëndërr, por çdonjëri do të pajtohet pa dyshim se ai gur nuk është asgjë më shumë se një perceptim i trurit.

Rezistenca e materialistëve për këtë çështje bazohet përgjithësisht në dështimin e tyre për ta kuptuar këtë. Ata ia kanë imponuar vetes besimin



Shqelmimi i një guri nuk dëshmon se njeriu ka të bëjë me gurin origjinal që ekziston jashtë tij. Guri për të cilin njeriu përjeton eksperiencë është vetëm një perceptim në tru. Ne mund ta përjetojmë perceptimin e njëjtë kur ëndërrojmë.

dogmatik në ekzistencën absolute të materies dhe me forcë i shmangen vënies së saj në pikëpyetje. Këtu, ne po e peshojmë dhe zbulojmë një të vërtetë që ata nuk dëshirojnë ta marrin parasysht: që nëse ata e pranojnë se kanë kontakt të drejtpërdrejt me materien origjinale, atëherë ata duhet gjithashtu ta konsiderojnë vetveten si “njeriun e vogël në majë të kullës.”

Kulla dhe dhoma e mbyllur në majë të saj

Imazhi i kullës, i cili e përcakton titullin e këtij libri, është vetëm një metaforë që ne kemi përdorur për të ndihmuar të qartësojmë këtë çështje.

Kuptimi i saj është ky: Nëse pohoni se ju bashkëveproni drejtpërdrejtë me origjinalet e dynjasë dhe të trupit tuaj, të cilat ekzistojnë jashtë trurit tuaj, atëherë ju duhet të pranoni ekzistencën e një trupi gjigant që i bart gjithë këto imazhe brenda kafkës suaj. Në atë rast, meqenëse ju perceptoni çdo gjë në trurin tuaj, ju jeni një person i vockël i mbyllur brenda një dhome të vockël, në majë të një kulle gjigante.

Si arrijmë në këtë përfundim? Le të gjykojmë, etapë pas etape:

1) Shikoni përreth jush në këtë moment, dhe do të shihni një numër të madh objektesh: mobilie, mure, shtëpi, njerëz, vetura, qiellin – dhe përveç gjithë këtyre, vetë trupin tuaj. Të gjitha këto objekte, duke përfshirë edhe vetë trupin tuaj, janë në të njëjtin vend.

2) Ku është ai vend? Përkujtoni sqarimet në faqet paraprirëse dhe do të kuptoni se ky “vend” nuk është askund tjetër pos në qendrën pamore brenda trurit tuaj. Me fjalë të tjera, e gjithë bota me të cilën keni të bëni, duke përfshirë vetë trupin tuaj, është një hapësirë prej vetëm disa centimetrash kub në trurin tuaj, në kafkën tuaj. Mu në këtë moment, ju po e shikoni këtë libër në atë pjesë të trurit tuaj. Duart që shihni, dhe ndjeni, ndërsa i shfletoni këto faqe janë po ashtu brenda qendrave të të pamurit dhe të prekurit në trurin tuaj. Të gjitha organet në trupin tuaj ndodhen në të njëjtin vend. Karriga ku jeni ulur ndërsa lexoni dhe dhoma në të cilën ndodhet ajo karrige, janë të gjitha aty po ashtu.

NJERIU I VOGËL NË KULLË

3) Andaj, a besoni se e shikoni trupin tuaj origjinal material e jo këtë perceptim brenda kafkës suaj? Nëse besoni se e shikoni një trup të tillë, atëherë duhet të kuptoni se kurrë nuk keni qenë në gjendje që ta perceptoni atë. As që nuk posedoni ndonjë informacion për atë se si mund të jetë ai. Gjithëçka që mund të bëni është të supozoni se si duket ai.


4) Nëse besoni se shikoni origjinalin e trupit tuaj, atëherë duhet të pranoni ekzistencën e një gjiganti jashtë trupit tuaj që ju e shikoni në këtë moment. Pasi që ju dhe çdo gjë që shihni – dhoma juaj dhe të gjitha objektet jashtë saj – ndodhen në qendrën e të pamurit të asaj kafke gjigante. Prandaj, trupi fizik i saj duhet të jetë poashtu vigan. Poshtë pjesës ku ju jeni në këtë moment, duhet të ndodhen shpatullat, krahët, një trup, këmbët dhe shputat (nëse ky gjigant është, në të vërtetë, një person me dy duar, dy këmbë sikurse edhe ju.)



Njeriu posedon eksperiencën/përvojën vetëm të perceptimit dhe imazhin e çdo gjëje që njeriu beson se posedon të formuar në tru. Dhe njeriu kurrë nuk mund t'i dijë format e tyre origjinale që ndodhen jashtë tij.

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR

Nëse pohoni se keni një trup pamjen e jashtme të të cilit ju e perceptoni nga jashtë, atëherë ju duhet të pranoni se jetoni të burgosur në majë të një kulle gjigante; që ju kurrë nuk mund ta lëni atë dhomë, por vetëm shikoni ekranin para jush.



5) Duke qenë kështu, ju duhet të jeni një qenie miniaturale njerëzore që jeton në një kafkë gjigante. Për ta thënë këtë ndryshe, përfytyroni se jeni të burgosur në një dhomë të mbyllur në majë të një kulle gjigante, duke mos qenë kurrë në gjendje ta braktisni atë dhomë dhe thjeshtë duke e shikuar një ekran të vendosur përpara jush. Në këtë analogji, kulla është trupi juaj, origjinalin e të cilit pohoni se e shikoni, ndërsa trupi që ju perceptoni është vetëm njeriu i vogël i burgosur në majë të asaj kulle.

NJERIU I VOGËL NË KULLË

Ju nuk mund ta shihni kurrë këtë kullë gjigante (dmth. origjinalin e trupit që ju mendoni se e shihni në mënyrë të drejtpërdrejtë), pasi që jeni i mbyllur në një dhomë të vockël në majën e saj. Ju nuk mund ta braktisni kurrë atë dhomë gjatë gjithë jetës suaj. Ju vetëm mund t'i shikoni imazhet e pasqyruara në muret e asaj dhome. Disa objekte në ato imazhe (yjet, për shembull) mund të duken se janë me miliona milje larg. E megjithatë e vërteta është se ju ende mbeteni në atë dhomë të vockël.

Për të kuptuar më mirë këtë çështje, merreni shembullin e filmave vizatimor që shpeshherë shfaqen në televizion. Në disa prej këtyre filmave vizatimor, një robot gjigant kontrollohet prej dikujt që është i ulur në qendrën komanduese në kokën e makinës. Për shembull, në filmin e mirënjohur Voltran, robotët gjigant drejtohen prej një njeriu të ulur në qendrën komanduese në pjesën e kokës. Roboti vepron në pajtim me urdhërat e atij personi. Komanduesi është një njeri i vockël i ulur brenda një njeriu mekanik me madhësi të një rrokaqielli.

Nëse besoni që ju bashkëveproni me origjinalin e trupit që shikoni dhe ndjeni në këtë moment, atëherë duhet ta pranoni këtë sistem. Për ta thënë këtë më ndryshe, ju duhet të pranoni që ju jeni një njeri i vogël i ulur në një dhomë në majë të një kulle, apo në majë të një roboti gjigant.

Merreni parasysh që trupi juaj që ju shikoni dhe përjetoni në këtë moment është përafërsisht 5 këmbë, nëntë inç – apo 1.80 centrimetra – i lartë. Atëherë, në kuptim të krahasimit, ju duhet të pranoni që trupi origjinal jashtë trurit tuaj, me të cilin besoni se keni kontakt të drejtpërdrejtë, ka madhësi gjigante. Në qoftë se trupi është një kullë dhe “Unë” që e përjeton atë është një person në një qeli në majë të asaj kulle, atëherë ajo kullë duhet të jetë me qindra këmbë e lartë. Në qoftë se keni një imazh të lartësisë 5' 9" të trupit të cilit i referoheni si “unë,” atëherë trupi jashtë, me të cilin ju pranoni se keni kontakt të drejtpërdrejtë, duhet të jetë më qindra këmbë i lartë.

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR

Edhe një tjetër shembull mund ta bëj këtë më të qartë. Dikush që pohon se është duke e shikuar veturën origjinale e cila ndodhet jashtë trurit të tij, edhe pse ai në të vërtetë e sheh perceptimin e saj në mendjen e tij, duhet të mendoj si vijon:

Imazhi i veturës formohet në trurin e një personi. Qendra e të pamurit nuk është më ka madhësi më të madhe se disa centimetra kub. Nëse imazhi i një veture disa këmbë e gjatë përputhet me atë hapësirë, atëherë qendra



Në filmin e famshëm vizatimor Voltran, një robot gjigant drejtohet nga një pilot që është i ulur në një dhomëz në kokën e tij.



NJERIU I VOGËL NË KULLË

pamore duhet të ketë së paku madhësinë e një veture.

Dhe në qoftë se ajo qendër është disa metra e madhe, atëherë truri i njeriut duhet të ketë dimensione proporcionalisht gjigante.

Nëse truri i njeriut zë një hapësirë aq të madhe, atëherë në proporcion me trurin e tij, një trup i njeriut duhet të ketë një madhësi prej disa miljesh.

Ne këtu po i referohemi vetëm dikujt që i hedh një shikim një makine. Merreni parasysh një person që e shikon një luginë disa milje të gjatë. Nëse ai pohon se e shikon origjinalin e luginës, atëherë qendra pamore e tij duhet, po ashtu, të zërë një hapësirë me madhësi prej së paku disa miljash katrorë. Po të jetë kështu, atëherë truri, organet e brendshme, duart, këmbët e atij personi duhet të jenë të gjitha në proporcion – dhe me dimensione kolosale.

Pasi që mundësitë e tilla nuk vijnë në shprehje, a nuk është krejtësisht e palogjikshme të pohohet se një veturë disa metra e gjatë, apo një luginë me madhësi prej disa kilometrash katrorë, ekzistojnë vërtet jashtë dhe se perceptuesi me të vërtetë ka të bëjë me to në format e tyre origjinale?



Nëse pohoni se po e shikoni origjinalin e një luginë të gjerë, atëherë qendra vizuale në trurin tuaj duhet të jetë një hapësirë disa milja katrorë për nga madhësia.







-III-

Erroneous

Belief

in the Tower

-III-
BESIMI I GABUAR
NË KULLË

Njeriu i vogël në kullë” nuk është një shpikje e jona, por përfundimi logjik i vargut të mendimit që mbrohet nga materializmi. Çdo materialist, i cili insiston në iluzionin e ekzistencës absolute të materies, duke pohuar që ne gëzojmë njohuri të drejtpërdrejtë të origjinalit të materies në botën e jashtme, është pikërisht në atë pozitë. Ai pohon se jashtë trupit që ai sheh dhe ndjen, ekziston edhe një tjetër trup që e bart andej-këtej atë trup të parë dhe hapësirën që e rrethon atë.

Një vlerësim i detajuar zbulon se sa e pakuptimt është kjo pamje e sajuar nga ky pohim materialist.

Në fakt, materialistët po e përshkruajnë një monstruozitë që do t'i

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR

tmerronte edhe vetë ata. Le ta përshkruajmë këtë pamje të frikshme më për së afërmi: materialisti po e përshkruan një gjigant që bart tërë gjithësinë në një hapësirë të vockël në kokën e tij, duke e vështruar atë nga afër. Pasi që Dielli, Hëna, yjet dhe të gjitha burimet e tjera të dritës janë në kokën e tij, gjiganti ynë duhet të jetë pashmangshëm në errësi. Nëse e bëjmë një krahasim me masën tonë, krahët dhe këmbët e këtij gjiganti janë me qindra këmbë të gjata. Me fjalë të tjera, materialistët arrijnë në përfundimin se duhet të ketë një qenie gjigante njerëzore, e cila e bart tërë gjithësinë në kokën e saj dhe ecën askush nuk e di se kund, në një errësi skëterrë.



Kur i marrim parasysh pretendimet materialiste, njeriu shtyhet të bëjë një pohim qartë absurd se ekziston një person gjigant i cili bart tërë gjithësinë në trurin e tij dhe i cili nuk ka ide se ku shkon!

Mirëpo, një vështrim më i vëmendshëm na tregon se besimi në teorinë e “qenies gjigante njerëzore” është vetëm një nevojë e filozofisë materialiste. Kjo për arsye se nuk ekziston nevojë tjetër për të besuar se ne bashkëveprojmë me origjinalin e trupit të cilin e shohim dhe prekim. Pse na duhet të besojmë në një dituri të tillë? Pse të pranojmë ekzistencën e një gjiganti të tillë si reale në mungesë të çfarëdo dëshmie, kur askush asnjëherë nuk ka zbuluar gjurmë të një gjëje të tillë?

Përveç pranimit të verbër të filozofisë materialiste, nuk ka arsye për të besuar në ekzistencën e një personi të tillë joreal material.

Materia e krijuar në sferën e perceptimeve dhe të imagjinatës

Tani udhëhiqemi drejt të vërtetës më të rëndësishme: Duke qenë se bota e vetme me të cilën kemi të bëjmë është ajo e perceptimeve, të gjitha këto perceptime duhet të krijohen dhe të na shfaqen ne nga një Krijues që posedon dituri, urtësi dhe fuqi të pafund. Ai Krijues është Allahu i Plotëfuqishëm – Zoti i të gjitha Botërave, me fjalët e Kur’anit.

Një shprehje më e qartë e kësaj të vërtete të rëndësishme është kjo: Allahu ka krijuar gjithëçka ekziston nga asgjëja. E megjithatë, siç kanë shkruar dijetarët Islamik, të gjitha qeniet u krijuan në sferën e “perceptimeve dhe të imagjinatës.” Duke qenë se Allahu ka frymëzuar Frymën e Tij në njeriun, njeriu percepton një pjesë të këtyre perceptimeve dhe u jep atyre emra të tillë si “dynjaja,” “gjithësia,” “materia,” dhe “objektet.” Sidoqoftë, është Allahu Që i mësoi njeriut këta emra. Të gjitha këto perceptime, të krijuara nga Allahu, i nënshtrohen Atij në mënyrë të pakushtëzuar dhe veprojnë në pajtim me Vullnetin e Tij. Asnjë qenie nuk është krijuar e pavarur nga Allahu. Vetëm Allahu është i vërtetë. Gjithëçka tjetër është një iluzion në rrafshin e perceptimeve.

Imam Rabbani, që konsiderohet si njëri ndër dijetarët më të mëdhenj në historinë e Islamit e shpjegon këtë në Letrat e tij:

Ekzistonte vetëm Allahu dhe nuk ekzistonte asgjë pos Tij.

Kur Ai dëshiroi të shfaqej përsosmëria e Tij e fshehtë, Ai e bëri secilin prej emrave të Tij dëshmi që përsosmëria e Tij të manifestohej në atë shfaqje.

Asgjë pos mos-qenies nuk është e përshtatshme për të qenë vendi i shfaqjes për qenien dhe subjektet e saj. Sepse dëshmia dhe pasqyra e çdo gjëje është pikërisht e kundërta e saj. Dhe e kundërta e qenies është vetë mos-qenia.


Prandaj, Allahu i Madhërisëm me fuqinë e Tij të përkryer përcaktoi në sferën e mos-qenies një dëshmi për secilin prej emrave të Tij. Dhe Ai e krijoi atë dëshmi në sferën e perceptimeve dhe të imagjinatës në kohën që Ai dëshiroi dhe në mënyrën që Ai dëshiroi ... Qëndrueshmëria e kësaj bote nuk është në rrafshin e jashtëm, por në rrafshin e perceptimit dhe të imagjinatës ... Madje edhe në rrafshin e jashtëm, asgjë nuk ka ekzistencë absolute përveç qenies dhe attributeve të Allahut të Plotëfuqishëm...²

Në një letër tjetër, Imam Rabbani përsëri vë në pah se e gjithë bota materiale u krijua vetëm në sferën e perceptimeve dhe të imagjinatës:



Lart, unë përdora fjalinë: “Krijimi i Allahut është në sferën e perceptimeve dhe të imagjinatës.” Kjo nënkupton se krijimi i Allahut është në një sferë ku objektet nuk kanë vazhdimësi apo ekzistencë përveç perceptimeve dhe imagjinatës.³

Nëse e analizojmë me vëmendje, Imam Rabbani po thekson se bota që ne shohim dhe të gjitha qeniet “në sferën e imagjinatës,” u krijuan në rrafshin e perceptimeve. Jashtë kësaj, gjithëçka ekziston, është Qenia e Allahut.

Siç kemi parë, faktet teknike tek të cilat kemi arritur me anë të fizikës dhe fiziologjisë moderne u shënuan qindra vite më parë nga dijetarët Islamik. Ato e vërtetojnë një të vërtetë: se materia është një iluzion. Ajo që me të vërtetë ekziston është Allahu, i Cili e krijoi materien nga asgjëja.



**... Ata dinë vetëm anën e
dukshme të kësaj jete,
ndërsa për jetën tjetër janë
të pakujdesshëm.
(Sure Rum: 6-7)**



**... Tek Allahu do të ktheheni
të gjithë e Ai do t'ju lajmerojë
për atë që keni punuar.**

(Sure Ma'ide: 105)



Materialism: A Hypothetical View of the Life of This World That Is Regarded as Real

Me të kuptuar këtë, e vërteta e shtjelluar këtu do t'i ndryshojë në tërësi pikëpamjet e njerëzve për botën.

Shumica e madhe e njerëzve jetojnë të pavetëdijshëm për këtë fshehtësi të madhe. Ata mendojnë se çdo gjë që shohin me sytë e tyre, që mbajnë në duar dhe i që i referohen si “materie,” ka një ekzistencë absolute, objektive. Njerëzit që bëjnë këtë gabim kanë një nga këto dy pikëpamje:

1) Materializmi: Disa prej tyre të cilët mendojnë se materia ekziston në mënyrë absolute pohojnë në mënyrë të gabuar se përveç materies, asgjë nuk ekziston. Emri i këtij besimi paragjykues është materializëm në kuptimin filozofik. Pasuesit e tij për shkak të mosdijes e mohojnë ekzistencën e qartë të Allahut, si edhe ekzistencën e shpirtit dhe të jetës pas vdekjes.

2) Gjysmë-materializmi: Të tjerët të cilët besojnë në ekzistencën absolute të materies besojnë në një dimension të ekzistencës përtej materies, megjithëse ende mendojnë se materia ka një ekzistencë “absolute” dhe se dimensionin tjetër i qenies është vetëm relativ. Ky gabim bazohet në koncepte të tilla të përhapura si “metafizika” dhe “e mbinatyrshmja.” Njerëzit të cilët mbrojnë besime të tilla mendojnë se materia ekziston në mënyrë absolute dhe se Allahu është diçka si radio valët (Pa dyshim se Allahu është mbi atë që i përshkruajnë Atij). Besimet paragjyquese si ai që Allahu është “në qiell” apo gjetiu në gjithësi janë produkte të këtij gabimi të njëjtë.

Të dyja këto pikëpamje krejtësisht të gabuara burojnë nga dështimi për ta kuptuar natyrën e vërtetë të kësaj bote. Siç shpall Allahu në Kur'an:

... Ai (Allahu) ndihmon kë të dojë dhe është i Plotfuqishëm e Mëshirëplotë. (Ky është) premtimi i Allahut, e Allahu nuk e thyen premtimin e vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë. Ata dinë vetëm anën e dukshme të kësaj jete, ndërsa për jetën tjetër janë të pakujdesshëm. (Sure Rum: 5-7)

Në këto vargje, fjala “e dukshme” është përkthim i fjalës arabe zahir. Koncepti i zahir i referohet dukjes së jashtme. Për dallim, ekziston po ashtu nocioni batin që nënkupton thelbin e gjërave që nuk është i dukshëm nga ana e jashtme, ose aspekti i brendshëm, ose kuptimi i brendshëm i tyre.

Jobesimtarët e njohin vetëm pamjen e jashtme të kësaj bote, që është arsyeja pse ata nuk mund ta kuptojnë ekzistencën e Allahut dhe pushtetin e Tij mbi çdo gjë që ekziston. Disa nga ata të cilët e mohojnë Allahun janë materialistët, të tjerët – gjysmë-materialistët – besojnë në ekzistencën e Tij, por nuk janë në gjendje ta kuptojnë fuqinë e Tij. Në Kur’an Allahu u drejtohet në hollësi atyre të cilët besojnë në ekzistencën e Tij, por nuk mund ta kuptojnë fuqinë dhe sundimin e Tij të pafund mbi çdo gjë, për çfarë arsye ata i përshkruajnë Atij shokë të ndryshëm.

Në anën tjetër, kushdo që e kupton se ne mund të kemi vetëm njohurinë e materies origjinale në botën e jashtme si një perceptim në mendjet tona është i shpëtuar nga gjithë këto gabime dhe e kupton aspektin batin të jetës së kësaj bote.

Një aspekt i rëndësishëm për këtë është zhdukja e konceptit të vendit.

Eliminimi i konceptit të vendit

E vetmja njohuri që ne kemi për çdo gjë që e mendojmë si materiale – vet trupat tonë, objektet përreth nesh, toka mbi të cilën ecim, Dielli, yjet dhe planetet – janë perceptimet e tyre në trurin tonë, sikurse edhe ëndrrat tona. Prandaj, ne nuk mund të kemi njohuri të drejtpërdrejtë të formave origjinale të këtyre materialeve.

Kushdo që e kupton këtë të vërtetë është i shpëtuar nga gabimet në të cilat bien shumica e njerëzve. Pyetja që e kryeson listën e këtyre gabimeve është pyetja: “Ku është Allahu?” që buron nga besimi në konceptin e hapësirës. Shumica e njerëzve mendojnë se Allahu është në hapësirën e përtejme, lart në qiell, ose banon në ndonjë pjesë tjetër të gjithësisë (Pa dyshim, Allahu është i pastër nga kjo).

Ky besim i paditur përshkruhet në Kur’an, në tregimin e faraonit, i cili

NJERIU I VOGËL NË KULLË

pohonte në mënyrën më të paditur se ai vetë ishte Zoti i Egjiptit (Pa dyshim se Allahu është i pastër nga kjo) dhe pohonte se Allahu ishte në qiell. Allahu e shpall këtë në vargjet vijuese:

Dhe Faraoni tha: “O Haman, ndërtoma një kullë që t’i arrij rrugët, rrugët e qiellit e të shoh Zotin e Musait...” (Sure Gafir: 36-37)

Megjithatë, Allahu është gjithandej dhe përfshin të gjitha vendet. Kjo e vërtetë shpjegohet gjithashtu në Kur’an:

Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni është Fytyra (ana) e Allahut. Vërtet, Allahu është Gjithëpërfshirës dhe i Gjithëdijshëm. (Sure Bekare: 115)

Si qenia e vetme absolute, Allahu përfshin tërë gjithësinë, gjithë njerëzit dhe vendet, qiejt dhe çdo gjë. Ai manifestohet në tërë gjithësinë. Sipas hadithit, Profeti ynë (savs) ka thënë se dikush që thotë se Allahu është në qiell po e thoshte të vërtetën. Por ky shpjegim në asnjë mënyrë nuk bie në kundërshtim me faktin se Allahu është gjithandej. Kjo për arsye se nëse dikush në vendin tuaj në Tokë i ngritë duart e tij dhe i lutet Allahut dhe mendon se Allahu është në qiell, ndërsa dikush në Polin Jugor i drejtohet Allahut në të njëjtën mënyrë, përderisa dikush tjetër në Polin Verior i ngritë duart e tij dhe edhe një tjetër individ në Japoni apo Amerikë apo Ekuador i ngritë duart e tij drejt qiellit në të njëjtën mënyrë dhe i drejtohet Allahut, atëherë është e pamundur të flitet për ndonjë drejtim të caktuar. Në të njëjtën mënyrë, nëse exhinët, engjëjt dhe demonët në pjesë të ndryshme në hapësirë dhe gjithësi gjithashtu luten me duart drejt qiellit, përsëri do të jetë e pamundur të flitet për një drejtim të caktuar dhe situata do të jetë po e njëjta në tërë gjithësinë. Ngado që të ktheheni, atje është fytyra e Allahut.

Pasi që Allahu është gjithandej, Ai është më afër nesh se çfarëdo tjetër. Ky fakt përjashton perceptimin e “largësisë,” nga i cili shumica e njerëzve mashtrohen përsëri. Rëndom, njerëzit iu referohen entiteteve që shohin afër

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR

vetvetes si të ishin “afër.” Të pyetur: “Cili është objekti më i afërt që shihni?” ata përgjigjen: “Rrobat e mia,” “Ora ime,” “Syzet e mia,” apo edhe “Vet trupi im.” E vërteta është se Allahu është më afër se cilado prej këtyre gjërave. Kjo shpallet në këtë mënyrë në një ajet të Kur’anit:

Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet. (Sure Kaf: 16)

Kushdo që e kupton këtë të vërtetë e kupton se Allahu është miku, mbrojtësi dhe ndihmësi i vetëm i tij. Në këtë mënyrë zbulohet sekreti i lutjes në Suren Fatiha, Suren e parë: “Vetëm Ty të adhurojmë. Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” Në të njëjtën mënyrë, besimtari e kupton se gjithëçka në këtë botë ndodhë me vullnetin e Allahut, funksionon në pajtim me fatin që Ai ka përcaktuar për të dhe nuk mund të dal kurrë jashtë vullnetit të Tij. Ky është të kuptuarit e sekretit të zbuluar në ajetin në vazhdim:

Atij i përket gjithëçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Gjithëçka i përulet Atij. (Sure Rum: 26)

Të kuptuarit se hapësira është vetëm perceptim i largon të gjitha keqkuptimet dhe dyshimet për atë se si do të jetohej jeta në Ahiret. Shumica që nuk besojnë në Ahiret apo që dyshojnë në ekzistencën e tij nuk mund të kuptojnë se si gjithësia, të cilën ata e përfytyrojnë të jetë e fiksuar dhe e pandryshueshme, do të përfundojë, për t’u zëvendësuar me një botë krejtësisht të re që përmban Parajsën dhe Ferrin. E vërteta është se pikërisht gjithësia që ata e përfytyrojnë të jetë e fiksuar dhe e pandryshueshme përbëhet nga tërësia e perceptimeve që Allahu u shpall shpirtërave të tyre. Për Allahun, është një gjë e thjeshtë që të largojë një nga perceptimet e një personi dhe t’ia jap atë një personi tjetër në vend të tij. Në të njëjtën mënyrë që ju mund të ëndërroni, por ta gjeni veten në një botë krejtësisht tjetër kur të zgjoheni (botën që ju e mendoni të jetë “reale”), në po atë mënyrë do ta bëni kalimin nga jeta e kësaj bote në Ahiret. Gjithësia që ju e përfytyroni të jetë e fiksuar dhe e pandryshueshme, por që ekziston vërtet vetëm përmes krijimit

NJERIU I VOGËL NË KULLË

të Allahut në çdo moment, do të zhduket në një tronditje të madhe, pas së cilës do të krijohen Parajsa dhe Ferri.

Çdonjëri që e kupton se materia është një iluzion, se hapësira është një perceptim në mendjet tona dhe se jeton në një botë të krijuar nga Allahu në sferën e imagjinatës dhe të perceptimeve, do të jetë i denjë për shumë më tepër sekrete. Për dallim nga shumica e njerëzve, ai do të jetë i shpëtuar nga hutia e përpjekjes për t'i kuptuar "shkaqet" (ngjarjet dhe qeniet e krijuara nga Allahu). Ai do të priret vetëm në faljen e rregullt të namazit, që është shkak i vetëm i vërtetë. Ai do të dijë se e vërteta është se si e mira ashtu edhe e keqja vijnë nga Allahu dhe do t'i lutet – dhe do të kërkojë ndihmë prej – Tij për të gjitha çështjet. Ai nuk do të konsumohet nga dëshira për mall e pasuri, sepse e di se mund të krijoj kontakt vetëm me perceptimet e pasurive që njerëzit aq shumë i lartësojnë në sytë e tyre – për shembull, shtëpitë e mëdha, veturat luksoze, rrobat e shtrenjta dhe autoritetin shoqëror dhe politik – brenda mendjes së tij. Ai nuk do t'ju shoqërojë ndonjë vlerë atyre, duke e ditur se Allahu i ka krijuar këto zbulime në dukje plot shkëlqim si prova. Ai ua dhuron dhe ua merr ato, kujtudo që Ai dëshiron.

Çdonjëri që e kupton se materia dhe hapësira janë iluzione është i liruar nga të pasurit frikë të ndonjë qenie tjetër pos Allahut. Çdo gjë që ai sheh është perceptim i krijuar nga Allahu dhe askush nuk mund t'i bëjë asgjë atij pa lejen e Allahut. Allahu është qenia e vetme e denjë për t'ia pasur frikën. Kushdo që e kupton këtë do të arrijë vlerat e larta morale të profetëve, siç përshkruhet në ajetin në vazhdim:

Raportet e shkakut dhe pasojës të përcaktuara nga Allahu

Ai i cili e kupton se materia dhe hapësira janë iluzione e kupton edhe një tjetër sekret të rëndësishëm të panjohur për shumicën e njerëzve: Raportet shkak-pasojë që vlejnë në këtë botë nuk janë rezultat i karakteristikave fizike të materies apo bashkëveprimeve midis njerëzve. Pasi që materia

**... Jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.
(Sure Al 'Imran: 185)**



NJERIU I VOGËL NË KULLË

është vetëm një perceptim, ajo nuk mund të ketë efekte fizike. Çdo efekt fizik është krijuar veçanërisht si perceptim. Një gur, për shembull, nuk e thyen një xham; imazhet e hedhjes së gurit dhe thyerjes së xhamit janë të krijuara veçan. Forca ngritëse e ujit që mban një anije mbi ujë apo ngritja aerodinamike që mban një aeroplan lart janë të krijuara si iluzione. Gjithë “forcat” e tilla në të vërtetë i takojnë Allahut. Allahu e shpall këtë të vërtetë në Kur’an si vijon:

A nuk i shohin shpendët mbi kokat e tyre, se si i hapin dhe i mbledhin krahët? Askush nuk i mban ata, përveç të Gjithëmëshirshmit; Ai, me të vërtetë, sheh çdo gjë. (Sure Mulk: 19)

A nuk e sheh ti, se Allahu ka vënë në shërbimin tuaj gjithçka që është në Tokë dhe anijet që lundrojnë nëpër det me urdhrin e Tij?! Është Ai që e mban qiellin që të mos bjerë në Tokë; kjo mund të ndodhë vetëm me lejen e Tij. Vërtet, Allahu është i Butë dhe i Mëshirshëm me njerëzit. (Sure Haxhxh: 65)

Gjithashtu, një besimtar i cili e kupton këtë sekret do të zhvillojë raporte domethënëse me të tjerët për dallim nga raportet sipërfaqësore shkak-pasojë që shumica e njerëzve i pranojnë. Sepse Allahu i ka krijuar të gjithë njerëzit dhe fatet e tyre, raportet e ndryshme shkak-pasojë midis njerëzve marrin formën e përcaktuar prej Tij. Në një ajet, për shembull, Allahu shpall këtë sekret:

O besimtarë! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t’ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë. Tek Allahu do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmërojë për atë që keni punuar. (Sure Ma’ide: 105)

Nëse muslimanët e arrijnë rrugën e vërtetë, atëherë ata që devijojnë prej

saj nuk mund t' u bëjnë kurrë dëm atyre. Ky është ligji i Allahut, edhe pse ai vlen vetëm për besimtarët të cilët e kuptojnë fuqinë e Tij dhe besojnë në Të, ashtu siç e meriton Ai. Në një ajet tjetër, Allahu shpall një ligj tjetër:

Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë. (Sure Nahl: 97)

Për besimtarët, shumë sekrete si ky e bëjnë botën një vend shumë të ndryshëm. Për jobesimtarët, jeta në këtë botë është vend i vuajtjes, përplot shqetësime, frika, dyshime dhe tensione. Por për besimtarët, ajo shndërrohet në një pritje të këndshme të Parajsës.

Përfundim

Në këtë libër është shqyrtuar thelbi i “materies” nga një perspektivë mjaft e ndryshme nga ajo në librat tonë të tjerë. (Për më shumë hollësi, shih Harun Jahja, Materia: Emri tjetër për iluzionin - Arastirma Publishing, 2001)

Analogjia e njeriut të vogël në kullë nxjerr në pah edhe një tjetër të vërtetë të rëndësishme:

Nëse besoni se keni kontakt të drejtpërdrejtë me origjinalin e materies atëherë trupi juaj i vërtetë nuk mund të jetë i njëjti që ju jeni duke e parë mu në këtë moment.

Ju duhet ta keni një trup tjetër “jashtë” – me fjalë të tjera, jashtë mendjes suaj – që ju kurrë nuk e keni parë apo ndier.

Dhe ai trup është një “gjigant,” shumë herë më i madh se trupi që ju jeni duke e parë në këtë moment.

Dhe se ju jeni një i burgosur, i ndryrë në një dhomë të vockël në majë të një kulle.

NJERIU I VOGËL NË KULLË

Thënë ndryshe, sipas të gjitha gjasave ju keni qenë duke jetuar me supozimin se trupi juaj jeton në këtë botë dhe se ju shihni përmes syve tuaj. Por ky është një iluzion.

Një përfundim më racional është se në fakt, kjo “kullë” nuk ekziston fare. Nuk ka prova se ajo ekziston! E vetmja gjë që na bën ta ndajmë këtë besim është paragjykimi se ne kemi njohuri të drejtpërdrejtë të materies origjinale.

Posa të lirohemi nga ky paragjykim, mund të kuptojmë se kjo botë është, në realitet, një vend shumë ndryshe: Gjithëçka që ne shohim dhe ndiejmë është një perceptim që Allahu ia ka zbuluar shpirtit tonë. E vetmja qenie absolute është Allahu i Plotfuqishëm, Zoti i Botërave dhe Krijuesi i çdo gjëje.

**Atij i përket gjithçka që
gjendet në qiej dhe në
Tokë. Gjithçka i përulet Atij.
(Sure Rum: 26)**

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR



SHTOJCË
KOMENTE LIDHUR
ME NJERIUN
NË KULLË

Nga shkencëtarët dhe mendimtarët e kohës së sotme.

Ndërsa po përgatitej ky libër, kemi pyetur një numër shkencëtarësh dhe mendimtarësh lidhur me faktet që ai parashtron. Përmes internetit, ne u kemi sqaruar anëtarëve të respektuar të universiteteve të zgjedhura se si ata nuk mund të kenë kurrë njohuri të drejtpërdrejt për materien dhe pastaj kemi kërkuar pikëpamjet e tyre. Shumica prej tyre kanë thënë se kjo ishte një pyetje e një rëndësie shumë të madhe të cilës mendimi materialist nuk ka mundur kurrë t'i jap përgjigje dhe se ata vet nuk mund të jepnin asnjë shpjegim për këtë çështje. Ja disa fragmente nga përgjigjet e tyre:

Ne nuk kemi kurrë kontakt të drejtpërdrejt me mjedisin tonë. Sistemi ynë shqisor krijon abstraksione të këtij informacioni. Për të qenë puna edhe më

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR

keq, sistemet tona shqisore madje as nuk e ruajnë atë informacion në formën e njëjtë – i tërë informacioni shqisor (prekja, temperatura, shijimi, shikimi, dëgjimi, erërat) shndërrohen në sinjale elektrike dhe kimike në tru. Është struktura e këtyre sinjaleve elektrike dhe kimike të cilave ne iu referohemi si “objekte” në mjediset tona...

Debra Spear, Ph.D.

Departamenti i Psikologjisë
State University në South Dakota

Unë vetë mendoj se ne njerëzit jemi shpirtëra, gjëra jomateriale që mendojnë të lidhur në mënyrë kauzale me trupat tonë në atë mënyrë që ajo që përjetojmë/ndiejmë/mendojmë/etj. varet nga gjendjet fizike të trurit dhe të sistemeve tona qendrore nervore.

Megjithatë kjo është një pikëpamje e diskutueshme. Shumë njerëz mendojnë se ne njerëzit jemi gjëra materiale, copa të mëdha mishi. Në pyetjen tuaj: “Kush është ai që sheh imazhin e kësaj porosie në tru?” ata do t’i përgjigjeshin: “Pse, ti je, natyrisht!” Ti, kjo copë e madhe mishi, ke ndjesi pamore kur struktura të caktuara elektrike formohen në trurin tënd – asgjë më shumë. Të tjerët mendojnë se ndjesitë pamore shkaktohen prej apo mbase shfaqen nga këto struktura elektrike, edhe pse dallojnë prej tyre.

Unë për vete nuk mendoj se trurët tonë e bëjnë përjetimin, besimin, të shpresuarit, ndjesinë, etj. Unë mendoj se “Unë” i bëj ato gjëra dhe se Unë nuk jam truri im. Unë jam i lidhur ngusht me trurin tim, i lidhur aq ngusht sa që dëmtimi i trurit tim më ndalon nga kryerja e gjithë këtyre gjërave. Por unë dalloj nga truri im. Çfarë jam Unë? Pasi që unë i shoh gjërat, unë jam një shpirt.

Dr. Tom Crisp

Departamenti i Filozofisë
Univerziteti i Shtetit të Floridas

NJERIU I VOGËL NË KULLË

Njerëzve nuk iu pëlqen të shqetësohen në rutinën e tyre të përditshme. Njerëzve u pëlqen rregulli, atyre u pëlqen të jenë nën kontroll, atyre u pëlqen që gjërat të jenë ashtu siç u pëlqen atyre. Ata nuk mund të përballen me pasiguri dhe kanë frikë që të mos kenë asnjë përgjigje. Ata kapen për posedimet e tyre materiale dhe pozitat e tyre shoqërore. Ata do t'i humbnin të gjitha këto po të mos ekzistonte një realitet i jashtëm. Dhe njerëzit kanë frikë të jenë vetëm, të kenë nevojë të merren me gjithë këto çështje vetë. Ata nuk kanë besim në fuqinë e tyre të menduarit dhe nuk janë të lirë. Dhe nuk e dinë se kush janë në të vërtetë, ata e karakterizojnë veten e tyre me gjërat jashtë tyre.

Kjo është arsyeja pse [ata i shmangen diskutimit të kësaj çështje].

Birte Schelling

Departamenti i Filozofisë
Univerziteti i Hamburgut

Ne mendojmë për veten tonë sikur përbëhemi prej një trupi, mendjeje dhe ndjenjave. Megjithatë, natyra jonë e vërtetë fundamentale është shpirti. Drita e brendshme dhe përgjigjja ndaj shumicës së pyetjeve tuaja burojnë nga kjo vetëdije... Vetëdija finale dhe intelekti... pranon dhe emiton informacion nga brenda dhe rreth nesh. Shpirti ynë është si një organ perceptimi për shpirtin/Zotin për të përjetuar aspektet e dukshme të shpirtit.

Robert W. Olson, PhD

Author of *Stepping Out Within*

Ky është një problem në të cilin filozofët kanë punuar për 3000 vjet... sikurse kur një dru i madh bie në pyll por atje nuk është askush për ta dëgjuar atë... a ekziston zëri?

Ne pa dyshim se jemi të burgosur të aparatit tonë perceptues shqisor dhe të trurit tonë. Ato janë sistemet ndërhyrëse që na ndajnë ne nga realiteti fizik i botës jashtë nesh... çkado që ajo mund të jetë në të vërtetë. Për më tepër, shumica e njerëzve nuk e kuptojnë se sistemet e aparateve shqisore që i bartin të dhënat e jashtme në trurin tonë kanë ndërprerje (sinapsa) në disa vende përgjatë këtij rrugëtimi. Në këto ndalesa sinaptike, shtohen të dhëna të tjera prej pjesëve të ndryshme të trurit... duke e pasuruar – apo duke e kontaminuar – në këtë mënyrë informacionin nga jashtë. Kjo është arsyeja pse e njëjta shtysë mund të na “duket” e ndryshme në kohë të ndryshme... bota duket ndryshe varësisht nga ajo se si ne ndihemi. Kështu që kushdo që mendon se ai/ajo e përjeton botën pikërisht ashtu siç është... gabohet.

Arnold B. Scheibel, MD

Departments of Anatomy and Psychiatry
UCLA

... [I]mazhi në trurin tonë dhe mjedisi ynë fizik janë dy gjëra të ndryshme. Realiteti... ekziston vetëm në trurin tonë. Nuk ka asnjë mënyrë që ne ta përjetojmë realitetin përveç se me trurin tonë. Një lule është e kuqe, sepse ajo absorbon një gjatësi valore komplementare me të kuqen. Nuk ka mundësi që të shihet gjatësia e vërtetë valore e ngjyrës së kuqe, e cila është 671 nm. Lulja duket e kuqe sepse ne na është thënë se ajo është e kuqe. Dhe ne e lidhim këtë përshtypje me ngrohtësinë (pasionin) apo eksitim (shenjë e ngjyrës së kuqe)... Pra të gjitha perceptimet që mund t'i krijojë truri ynë janë një përzierje e

NJERIU I VOGËL NË KULLË

sinjaleve elektrike dhe kimike që na krijojnë përshtypjen si të ishin reale, por në realitet nuk janë reale.

Prof. Dr. Norbert Hilschmann

(Emeritus (profesor i pensionuar))

Drejtor i Institutit për Medicinë Eksperimentale të Maks Plankut

Imazhi nuk varet nga drita, natyrisht. Një goditje në kokë bën që ju t'i shihni yjet që janë një iluzion i plotë ...

Ajo që ju po e përshkruani vlen për të gjitha ndjesitë. E gjitha që ne ndonjëherë dimë për realitetin është një pasqyrim i realitetit "i skicuar" në grupet e qelizave të trurit. Ne ndonjëherë e kuptojmë gabimisht, si në rastin e iluzionit të një gjymtyre "fantazmë" pas amputimit...

Në aspektin teorik është e mundshme që asgjë nuk ekziston atje jashtë. Që e gjithë jeta është një iluzion i plotë. Apo që, si në filmin "Matriks," ne jemi trupa real të kyçur në një program kompjuterik i cili e furnizon trurin tonë me sinjale iluzore të një realiteti virtual. Nuk ka asnjë mënyrë ta dimë me siguri, se a është i mirë ky iluzion.

Andrew Paul Bendrups, MSc PhD

Department of Human Physiology and Anatomy
La Trobe University, Australia

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR



SHTOJCË II

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të Krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të rregullit të mrekullueshëm në gjithësi dhe në gjallesa, si edhe me anë të zbulimit të rreth 300 milion fosileve që zbulojnë se evolucionit nuk ka ndodhur kurrë. Në këtë mënyrë, shkenca vërtetoi faktin se All-llahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda që zhvillohet sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshtrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e

evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darwinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme si biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darwinizmit dhe e përdorin faktin e krijimit për ta shpjeguar zanafillën e jetës.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

Dështimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përfaqhua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre

NJERIU I VOGËL NË KULLË

vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmblihet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.
- 3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha llojet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona lloje të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

"Jeta buron nga jeta"

Në librin e tij, Darvini nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Kuptimi primitiv i shkencës në kohën e tij mbështetej në supozimin se gjallesat kishin një përbërje shumë të thjeshtë. Që nga mesjeta, krijimi spontan, sipas të cilit lëndët e pajetë u bashkuan për të formuar organizma të gjallë, ishte

një gjë e pranuar botërisht. Përgjithësisht besohej se insektet krijoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të vërtetuar këtë teori, u bënë eksperimente interesante. Pak grurë vendosej mbi një leckë të dhe besohej që pas një kohe minjtë do të krijoheshin.

Gjithashtu, zhvillimi i krimbave në një copë mishi merrej si dëshmi e krijimit spontan. Por, më vonë u kuptua se krimbat nuk u shfaqën vetvetiu në mish, por u bartën atje nga mizat në formë të larvave të padukshme për sy të lirë.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret mund të krijoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Mirëpo, 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster bëri të ditura rezultatet e tij pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata, që hodhën poshtë krijimin spontan, një gur-themel të teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: “Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej goditjes vdekjeprurëse të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”⁴

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë këto zbulime. Mirëpo, pasi që zhvillimi i shkencës shpalosi ndërtimin kompleks të qelizës së një qenie të gjallë, ideja se jeta mund të krijohej rastësisht hasi në një qorrsoak edhe më të madh.

Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.⁵

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të

NJERIU I VOGËL NË KULLË

gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Mileri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohet se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.⁶

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Mileri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.⁷

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën “Earth (Toka)”, pranon këtë fakt:

Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?⁸

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e

qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10950 (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 1050 konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohesh një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës Scientific American të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njërën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.⁹

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme

NJERIU I VOGËL NË KULLË

është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror”...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t’i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij Origjina e Llojeve u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s’mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.¹⁰

Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t’i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen lloje të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.¹¹

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencë e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefikas.

Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh, veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja ka një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t’i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për

të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.¹²

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një lloje, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha llojet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të

kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin llojet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”³⁴

Megjithatë, Darvini ishte më se i vetëdijshëm se ende nuk ishin gjetur fosile të këtyre formave të ndërmjetme. Ai e konsideronte këtë si pengesë madhore për këtë teori. Në një kapitull të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë,” ai shkroi:

Përse, nëse llojet kanë prejardhje nga llojet tjera përmes ndryshimeve delikate graduale, nuk shohim gjithandej forma të panumërta kalimtare? Përse nuk është e gjithë natyra në rrëmuje në vend se llojet të jenë, siç i shohim, të definuara mirë? ... Por, pasi që sipas kësaj teorie duhet të kenë ekzistuar forma të panumërta kalimtare, përse nuk i gjejmë ato të ngulitura në koren e tokës? ... Përse atëherë nuk është çdo formacion gjeologjik dhe çdo shtresë

NJERIU I VOGËL NË KULLË

përplot me hallka të tilla kalimtare? Gjeologjia sigurisht nuk zbulon çfarëdo zinxhiri të tillë organik të shkallëzuar në mënyrë të përsosur; dhe kjo, mbase, është kundërshtimi më i dukshëm dhe më serioz që mund t'i bëhet teorisë sime.¹⁴

Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, **hasim gjithnjë e më tepër jo në evolucion gradual, por në shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.**¹⁵

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të plotë, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që të gjitha gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një lloj i gjallë të shfaqet papritmas i plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ai u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Daglas Futujuma:

Krijimi dhe evolucionin janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucionin, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk

janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga lloje që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.¹⁶

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por Krijimi.

Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar: 1. Australopithecus

1. Australopithecus
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një lloje e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.¹⁷

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo”

NJERIU I VOGËL NË KULLË

ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majer, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”¹⁸

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto lloje kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleoantropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.¹⁹

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiensi, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.²⁰

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto lloje nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gold, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrrokakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhën) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.²¹

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një

mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucionin e njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë²²

Përralla për evolucionin njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragykuara të fosileve të zvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

Formula e Darvinit!

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta

NJERIU I VOGËL NË KULLË

shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomesh nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magnezi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojmë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t’i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepja, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallonj, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me

të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilësdo prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të All-llahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

Technology in the Eye and the Ear

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj

NJERIU I VOGËL NË KULLË

ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekрани më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. Do të thotë, truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri. Në trurin tuaj, i cili është i izoluar nga

tingujt, ju dëgjoni simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Deri më sot, asnjë aparat vizual apo regjistruar i bërë nga njeriu nuk ka qenë aq i ndjeshëm dhe i suksesshëm në marrjen e të dhënave shqisore si syri dhe veshi. Mirëpo, për sa i përket të pamurit dhe të dëgjuarit, një e vërtetë shumë më madhështore qëndron pas gjithë kësaj.

Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe,

NJERIU I VOGËL NË KULLË

tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej All-llahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për All-llahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një besim materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiquen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja është se kjo teori është situatë të krijuar është një besim dogmatik i domosdoshëm për disa qarqe. Këto qarqe janë verbërisht besnike ndaj filozofisë materialiste dhe e pranojnë darvinizmin sepse ai është

shpjegimi i vetëm materialist që mund të prezantohet për të shpjeguar funksionimin e natyrës.

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.²³

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pjetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona lloje të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pjetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është All-llahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e evolucionit: Magjia më e fuqishme në botë

Çdo njeri i lirë prej paragjykimeve dhe ndikimit të çfarëdo lloj ideologjie, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkuqton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Sic u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijonin profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sebes, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, All-llahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i

paralajmërove - ata nuk besojnë. All-llahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Surja Bekare: 6-7)

...ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit. (Surja A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Surja Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

NJERIU I VOGËL NË KULLË

“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjtë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Surja A’raf: 116)

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Surja A’raf: 117-118)

Siç mund të shohim, kur njerëzit e kuptuan se ata kishin qenë të magjepsur dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën tërë besueshmërinë. Edhe në ditët tona po ashtu, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato nën maskën e tyre shkencore, i braktisin besimet e tyre paragjyquese, ata po ashtu do të poshtërohen kur të shfaqet e vërteta e plotë dhe magjia të prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, i cili ishte një ateist që mbrojti teorinë e evolucionit për rreth 60 vite, por i cili më pas e kuptoi të vërtetën, zbulon pozitën në të cilën do të gjendet teoria e evolucionit në të ardhmen e afërt me këto fjalë:

Unë personalisht jam i bindur se **teoria e evolucionit**, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, **do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen.** Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo përmban.²⁴

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.



***“Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne
dimë vetëm atë që na ke
mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i
Gjithëdituri, i Urti.”
(Sure Bekare: 32)***



SHĒNIME

1. World Book Multimedia Encyclopedia, "Dream", World Book Inc., 1998.
2. Imam Rabbani, Letters of Rabbani, Vol II, Letter 470, pp. 517-518.
3. Imam Rabbani, Letters of Rabbani, Vol II, Letter 357, p. 163.
4. Sidney Fox, Klaus Dose, Molecular Evolution and The Origin of Life, W. H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
5. Alexander I. Oparin, Origin of Life, Dover Publications, New York, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
6. "New Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life," Bulletin of the American Meteorological Society, vol 63, November 1982, 1328-1330.
7. Stanley Miller, Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules, 1986, p. 7.
8. Jeffrey Bada, Earth, February 1998, p. 40.
9. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth," Scientific American, vol. 271, October 1994, p. 78.
10. Charles Darwin, The Origin of Species by Means of Natural Selection, The Modern Library, New York, p. 127.
11. Charles Darwin, The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition, Harvard University Press, 1964, p. 184.
12. B. G. Ranganathan, Origins?, Pennsylvania: The Banner of Truth Trust, 1988, p. 7.
13. Charles Darwin, The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition, p. 179.
14. Charles Darwin, The Origin of Species, p. 172.
15. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record," Proceedings of the British Geological Association, vol 87, 1976, p. 133.
16. Douglas J. Futuyma, Science on Trial, Pantheon Books, New York, 1983, p. 197.

HARUN JAHJA - ADNAN OKTAR

17. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, Toplinger Publications, New York, 1970, 75-14; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, 389.
18. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final answers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
19. Alan Walker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Antropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., New York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
20. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist With Modern Humans," *Time*, 23 December 1996.
21. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
22. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, p. 19.
23. Richard Lewontin, "The Demon-Haunted World," *The New York Review of Books*, January 9, 1997, p. 28.
24. Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, p. 43.